



RAPORTI VJETOR 2020

PËRMBAJTJA

HYRJE	6
I. FUNKSIONIMI I DREJTORISE SE PERGJITHSHME TE TATIMEVE.....	6
Misioni.....	6
II.REALIZIMI I TË ARDHURAVE	8
1. Menaxhimi sipas objektivave.....	8
2. Të ardhurat e vitit 2020	8
Grafik 1. Struktura e të ardhurave.....	11
Tabela 1. Totali DPT 12 Mujori 2020.....	11
Tabela 2. Të ardhurat e realizuara për vitin 2020 sipas DRT-ve (000 leke)	13
Tabela 3. Të ardhura nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (000 leke)	14
Tabela 4. Te ardhura nga Tatimi mbi Fitimin 12 Mujori (000 leke).....	14
Tabela 5. Te ardhura nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale (000 leke)	15
Tabela 6. Krahasimi TAP sipas zërave (000 leke).....	15
Tabela 7. Të ardhura nga Taksat Kombëtare dhe Tarifa (000 leke).....	16
Tabela 8. Taksat Kombëtare dhe Tarifat sipas llojeve (përfshirë Tarifa Buxhetore).....	17
Tabela 9. Të ardhura nga Taksa e Qarkullimit Rrugor (000 leke)	18
Tabela 10. Të ardhurat nga Sigurimet Shoqërore & Shëndetësore	18
3. Sektori i Kontabilitetit dhe Pageses	18
III. SHËRBIMI I TATIMPAGUESVE	21
1. Struktura e Drejtorisë	21
2. Objektivat e Drejtorisë për vitin 2020.....	22
3. Treguesit kryesorë të performancës	23
4. Aktivitetet e programuara dhe realizuara gjatë vitit 2020 në funksion të realizimit të objektivave.....	24
IV. PERFORMANCA TEKNIKO-LIGJORE	28
1. HYRJE	28
1.1 Detyrat kryesore të Drejtorisë Teknike dhe Ligjore.....	28
1.2 Organizimi i Drejtorisë Teknike dhe Ligjore	29
2. OBJEKTIVAT E DREJTORISË PËR VITIN 2020	29
3. AKTIVITET E PROGRAMUARA DHE REALIZUARA GJATË VITIT 2020 NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË OBJEKTIVAVE.....	30
3.1 SEKTORI I ÇËSHTJEVE LIGJORE.....	30
3.2 ÇËSHTJET TEKNIKE	33
3.3 SEKTORI I TAKSAVE DIREKTE	35
V. KONTROLI TATIMOR.....	39

1. Përzgjedhja për Kontroll.....	40
2. Objektivat për vitin 2020.....	40
3. Aktivitete të realizuara për vitin 2020 dhe problematikat	42
VI.MENAXHIMI I RISKUT	44
1. Objektivat e Drejtorise per vitin 2020	44
2. Planet sektoriale te realizuara gjate vitit 2020	45
3. Permiresimi i Modulit te Riskut	46
3.1 Marreveshjet e Bashkepunimit Nder-institucional.....	48
3.2 Analizimi i riskut te tatimpaguesve qe bejne Kerkese per Rimbursim.....	48
3.3 Ndryshimi i pergjegjesive tatimore bazuar ne te dhenat e paisjeve fiskale dhe deklaratat mujore te TVSH-se.....	49
4. Analiza periodike per tatime te vecanta dhe per sektore te caktuar	50
5. Te tjera aktivitete te realizuara nga DMR gjate vitit 2020.	52
VII. MBLEDHJA ME FORCË	55
Grafiku 1 Detyrimet sipas Llojit të Tatimit.....	56
Grafiku 2. Detyrimet sipas Llojit të Tatimit 2019 vs 2020	56
Tabela 1. Moshja e detyrimeve te papaguara ne afat.....	57
Grafiku 3. Detyrimet sipas statusit te tatimpaguesit.....	57
VIII. RIMBURSIMI I TVSH-SË	59
1. Objekti dhe detyrat e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së.....	59
2. Baza Ligjore.....	59
3. Aktivitetet e realizuara për vitin 2020	61
3.1 Trajtimi dhe Rimbursimi i kerkesave per rimbursim te TVSH-se sipas afateve ligjore;.....	61
3.2 Rishikimi i Rregullores së Rimbursimit të TVSH-së;	64
3.3 Publikimi i Stokut të Rimbursimit të TVSH-së.....	65
3.4 Automatizimi i sistemit te trajtimit te kerkesave per rimbursim.....	65
IX. HETIMI TATIMOR	66
Tabela 1. Ndjekja e denoncimeve	67
Referime per veprat penale Janar- Dhjetor 2020.....	67
Grafik 2. Referime të veprave penale në prokurori ndër vite.....	68
Grafik 3. Referimet e rasteve sipas prokurorive	68
X. MARRËDHËNIET DHE KOORDINIMI INSTITUCIONAL DHE MENAXHIMI I PROJEKTEVE	69
Përshkrim i shkurtër i DMJMP (dhe DMKN me strukturën e vjetër organizative)	69
Detyrat funksionale	69
Objektivat për vitin 2020.....	71

Treguesit kryesore të performancës	71
Aktivitetet e programuara dhe realizuara gjatë 2020 në funksion të realizimit të objektivave.	71
Projekti për Shkëmbimin Automatik të Informacionit	73
Projekti i Fiskalizimit	74
XI.BURIMET NJEREZORE	77
STRUKTURA ORGANIZATIVE	77
REKOMANDIME TË FMN-së.....	81
TRAJNIMI DHE NGRITJA E KAPACITEVE TË BURIMEVE NJERËZORE	84
MASAT DISIPLINORE	85
TË DHËNAT PËR VLERËSIMET E REZULTATEVE NË PUNË PËR VITIN 2020	86
XII. BUXHETI DHE FINANCA.....	89
Tabela 1. Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve Viti 2020.....	89
Tabela 2. Raporti i Shpezimeve sipas artikujve buxhetore Viti 2020	89
Tabela 3. Projektet e investimeve	90
XIII. DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PROKURIMEVE.....	91
XIV. DIBA	96

Raporti vjetor i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është një dokument publik, i cili ngarkohet në faqen zyrtare të internetit, www.tatime.gov.al

Shkurtime	
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DRT	Drejtoria Rajonale Tatimore
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
TAP	Tatimi mbi të Ardhurat Personale
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
RPA	Regjimi i Përpunimit Aktiv

HYRJE

I.FUNKSIONIMI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

Misioni

Administrata Tatimore Qendrore administron mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe kontributeve shoqërore, duke nxitur përmbushjen vullnetare dhe duke kërkuar nga të gjithë kuptimin dhe respektimin e detyrimeve ligjore.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është autoriteti shtetëror i specializuar, në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për krijimin, sigurimin dhe mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.

Institucioni është i organizuar në nivel qendror me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përgjegjëse për hartimin, monitorimin dhe zbatimin e strategjive dhe politikave operationale efikase në realizimin e misionit të institucionit. Në nivel rajonal, institucioni ka 14 Drejtori Rajonale Tatimore dhe në total në organikën e administratës tatimore shqiptare numërohen 1271 punonjës duke e renditur administratën tatimore si një nga institucionet ligj zbatues më të rëndësishme në vend.

Në këtë frymë, administrata tatimore nisur edhe nga praktikat e shumë vende anëtare të BE-së që kanë ndryshuar qëndrimin e tyre ndaj taksapaguesve, duke u larguar nga monitorimi i njëanshëm i përmbushjes së detyrimeve tatimore, u orientua drejt një marrëdhënieje proaktive dhe partneriteti me tatimpaguesit, duke investuar në forcimin e besimit të tatimpaguesve në përmbushje të nevojave të tyre. Përvoja tregon se tatimpaguesit e informuar kanë më shumë gjasa të përmbushin detyrimet e tyre në mënyrë të rregullt dhe kjo ka dhënë efekte të matshme e pozitive të cilat do t'i gjeni në treguesit statistikorë në këtë raport.

Të dhënat e vitit 2020 tregojnë se angazhimi serioz në luftën kundër informalitetit ka dhënë efektet e pritura të cilat shërbejnë si indikator për rritjen e besimit dhe sigurimin e një mjedisi të shëndoshë ekonomik.

Objektivat strategjikë nga të cilat AT udhëhiqet janë:

- Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare, përmes:
 - Ofrimit të shërbimeve cilësore dhe reduktimit të barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore.
 - Rritjes së ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë dhe kuptimin e rolit të Administratës Tatimore në shoqëri.
- Zbatimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i rasteve të mashtrimit

tatimor, përmes:

- Zbatimit të strategjisë së përmbushjes së menaxhimit të riskut ,
- Përmirësimit të mëtejshëm të kontrollit tatimor dhe gjurmimit të mashtremeve tatimore,
- Mbledhjes efikase dhe efektive të borxhit ,
- Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, përmes;
 - Aplikimit të metodave dhe sistemeve për të menaxhuar një administratë tatimore moderne,
 - Zhvillimit të kapaciteteve dhe motivimit të punonjësve,
 - Mbajtjes së proceseve optimale dhe strukturës së Administratës Tatimore,
 - Zhvillimit dhe përmirësimit të partneriteteve,
 - Modernizimit dhe rinovimit të infrastrukturës,
 - Kënaqësia nga shërbimet elektronike të tatimeve është dukshëm më e lartë në 2020 në të gjitha aspektet e vlerësuara, si aksesit, besueshmëria dhe saktësia e përpunimit të të dhënave,
 - Një rritje e konsiderueshme në vlerësimin për cilësinë e raportit të auditimit, si dhe sjelljen dhe etikën e inspektorëve,
 - Një rritje të ndjeshme në ndërgjegjësimin e tatimpaguesve për Modulin e Analizës së Riskut dhe përzgjedhjen për inspektim bazuar në të.

II.REALIZIMI I TË ARDHURAVE

1. Menaxhimi sipas objektivave

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2020 një ndër objektivat kryesor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ka qenë:

- Rritja e pajtueshmërisë vullnetare,
- Rritja e performancës së mbledhjes të të ardhurave tatimore mbi parashikimet aktuale
- Përmirësimi dhe sigurimi i shërbimeve më të mira për tatimpaguesit,
- Reforma kundër informalitetit dhe fokusi në mirë-administrim,
- Trajnimi i vazhdueshëm për nënpunësit e të gjitha niveleve.

Në arritjen e objektivave janë mbajtur në konsideratë:

- Përmirësimi i administrimit të mbledhjes së tatimeve me efekte në rritjen e tyre.
- Efektet e paketës fiskale për vitin 2020.
- Forcimi i mbledhjes së taksave bazuar në strategjinë e riskut të pajtueshmërisë.
- Përzgjedhja dhe trajnimi i stafit të administratës tatimore.

2. Të ardhurat e vitit 2020

Administrata Tatimore Qendrore, për periudhën 12 mujore 2020, paraqet një performancë pozitive në mbledhjen e të ardhurave. Vendosmëria e administratës për të luftuar evazionin dhe ekonominë informale, si dhe fushatat sensibilizuese të ndërmarra kanë ndikuar në prirjen rritëse të të ardhurave.

Struktura e të ardhurave

Struktura e mbledhjes së të ardhurave përbëhet nga:

- Të ardhurat tatimore neto përbëjnë **57%** të të ardhurave totale neto
- Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore përbëjnë **43%** të të ardhurave totale neto.

Për vitin 2020, të ardhurat tatimore bruto gjithsej janë programuar 246.5 miliard lekë dhe janë realizuar 235.5 miliard lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 11 miliard lekë ose 4.45 % më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, me realizim të ardhurash 259.5 miliard lekë, rënia e të ardhurave tatimore është 24 miliard lekë më pak ose 9.24 % më pak.

Nga të dhënat statistikore të evidencës së realizimit të të ardhurave për këtë periudhë rezulton:

Të Ardhurat Tatimore

Për vitin 2020, të ardhurat tatimore janë programuar 155.6 miliard lekë dhe janë realizuar 141.4 miliard lekë, me një mosrealizim prej 14.2 miliard lekë ose 9.13 % më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, në të cilën të ardhurat u realizuan 165.3 miliard lekë, rezultatet janë në ulje me 23.9 miliard lekë më pak ose 14.47 % më pak.

Të Ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore

Për vitin 2020, të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore janë programuar 90.9 miliard lekë dhe janë realizuar 94.1 miliard lekë, me një rritje prej 3.2 miliard lekë ose 3.54 % më shumë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, ku të ardhurat nga KSSHSH ishin 94.2 miliard lekë, rezultatet janë në rënie me 50 milionë lekë më pak ose 0.1 % më pak.

2.1. Të Ardhurat Tatimore ndarë sipas llojit

Realizimi i të ardhurave sipas llojit të tatimeve krahasuar me planin e vitit 2020 dhe faktin e vitit 2019, për periudhën Janar – Dhjetor 2020, bazuar në të dhënat statistikore, paraqitet si më poshtë:

2.1.1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Për 12 mujorin 2020, të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (neto) ishin programuar në vlerën prej 29.6 miliard lekë dhe janë realizuar në vlerën prej 29.7 miliard lekë, me një mbirealizim në vlerë prej 3.3 milionë lekë ose 0.01 % më shumë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, në të cilën u arkëtuan 25.9 miliard lekë, të ardhurat nga TVSH-ja neto janë arkëtuar 3.7 miliard lekë më shumë ose 14.3 % më shumë.

2.1.2. Rimbursimi i Tvsh-së

Për 12 mujorin 2020 rimbursimi për TVSH-në ishte programuar 21.0 miliard lekë dhe është realizuar në vlerën 16.5 miliard lekë me një mosrealizim prej 4.5 miliard lekë ose 21.37 % më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 në të cilën janë rimbursuar 23.5 miliard lekë, rimbursimet janë realizuar me 7.0 miliard lekë më pak ose 29.77% më pak.

2.1.3. Tatimi mbi Fitimin

Të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi Fitimin, janë programuar 30.4 miliard lekë dhe aktualisht janë arkëtuar 28.4 miliard lekë, me një mosrealizim prej 2.0 miliard lekë ose 6.68% më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, në të cilën u arkëtuan 36.4 miliard lekë, të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 8.1 miliard lekë më pak ose 22.27% më pak.

2.1.4. Tatimi mbi të Ardhurat Personale

Tatimi mbi të ardhurat personale është programuar 41.1 miliard lekë dhe është realizuar 37.1 miliard lekë, me një mosrealizim prej 4.0 miliard lekë ose 9.76 % më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, në të cilin u arkëtuan 46.2 miliard lekë, të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 9.2 miliard lekë më pak ose 19.81% më pak.

2.1.5. Taksat Kombëtare dhe Tarifa

Të ardhurat tatimore nga Taksat dhe Tarifa Kombëtare janë programuar në vlerën 13.6 miliard lekë dhe faktikisht janë arkëtuar 11.9 miliard lekë, me një mosrealizim 1.7 miliard lekë ose 12.63% më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, në të cilën u arkëtuan 13.2 miliard lekë, mbledhja e taksave është në ulje prej 1.3 miliard lekë ose 9.91 % më pak.

2.1.6. Taksa e Qarkullimit Rrugor

Të ardhurat tatimore nga Taksat e Qarkullimit dhe Karburantit, të cilat janë programuar 19.2 miliard lekë, janë arkëtuar 17.0 miliard lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 2.2 miliard lekë ose 11.28 % më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, në të cilën u arkëtuan 18.8 miliard lekë, të ardhurat janë realizuar me ulje prej 1.7 miliard lekë ose 9.17 % më pak.

Struktura e të Ardhurave Tatimore për periudhën 12 mujore 2020

Struktura e të ardhurave tatimore tregon se:

- TVSH-ja vazhdon të jetë kontribuesi kryesor në të hyrat publike me 32.7% të të ardhurave tatimore.
- Tatimi mbi të ardhurat personale përbën 26.2 % të të ardhurave tatimore,
- Tatimi mbi fitimin zë 20.1 % të të ardhurave tatimore,
- Taksa e qarkullimit me 12.0% të të ardhurave tatimore.

Grafik 1. Struktura e të ardhurave




Tabela 1. Totali DPT 12 Mujori 2020

E M E R T I M I		FAKTET		PLAN I	Diferenca Fakt Plan		Diferenca 2020- 2020	
		2019	2020	2020	+ ose -	Përqindje	+ ose -	Përqindje
	D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)	259,461,414	235,499,428	246,480,000	(10,980,572)	-4.45%	(23,961,985)	-9.24%
A	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arketim)	165,294,011	141,382,557	155,580,000	(14,197,443)	-9.13%	(23,911,455)	-14.47%
1	TVSH (bruto)	49,456,618	46,174,825	50,660,000	(4,485,175)	-8.85%	(3,281,793)	-6.64%
	- TVSH (neto)	25,947,162	29,663,293	29,660,000	3,293	0.01%	3,716,131	14.32%
	- Rimbursimi i kryer	23,509,456	16,511,532	21,000,000	(4,488,468)	-21.37%	(6,997,924)	-29.77%
2	Tatim mbi Fitimin	36,484,399	28,358,795	30,390,000	(2,031,205)	-6.68%	(8,125,604)	-22.27%
3	Ardhura Personale	46,226,037	37,069,163	41,080,000	(4,010,837)	-9.76%	(9,156,874)	-19.81%
4	Taksat Nacionale	13,211,686	11,903,013	13,624,000	(1,720,987)	-12.63%	(1,308,672)	-9.91%
5	Taksa e Qarkullimit Rrugor	18,754,453	17,033,877	19,200,000	(2,166,123)	-11.28%	(1,720,576)	-9.17%
6	Lojrat e Fatit	910,263	726,963	626,000	100,963	16.13%	(183,300)	-20.14%
7	Te tjera pa identifikuar	(0.02)	0	0	0.00		0.02	0.00%
8	Denimet Administrative	250,556	115,920	0	115,920		(134,636)	-53.73%
B	Te Ardhurat Tatimore (neto)	141,784,555	124,871,024	134,580,000	(9,708,976)	-7.21%	(16,913,531)	-11.93%

C	Kontributet e Sigurimeve	94,167,402	94,116,872	90,900,000	3,216,872	3.54%	(50,531)	-0.05%
D	D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto)	235,951,958	218,987,896	225,480,000	(6,492,104)	-2.88%	(16,964,062)	-7.19%

Tabela 2. Të ardhurat e realizuara për vitin 2020 sipas DRT-ve (000 leke)

	Te ardhura Total Bruto			Te ardhura Tatimore Neto			Sigurime Shoqerore		
	Fakt	Plan	%	Fakt	Plan	%	Fakt	Plan	%
Berat	3,436,374	3,545,000	-3.06%	3,096,533	3,145,000	-1.54%	2,244,680	2,270,000	-1.12%
Diber	2,796,761	3,355,000	-16.64%	2,172,819	3,185,000	-31.78%	1,901,750	1,950,000	-2.47%
Durres	13,211,494	13,780,000	-4.13%	12,187,869	12,080,000	0.89%	8,165,852	7,930,000	2.97%
Elbasan	6,521,513	6,420,000	1.58%	6,040,265	6,060,000	-0.33%	4,225,605	4,100,000	3.06%
Fier	7,481,537	7,800,000	-4.08%	6,608,907	6,800,000	-2.81%	4,755,100	4,700,000	1.17%
Gjirokaster	2,659,726	2,450,000	8.56%	2,612,447	2,310,000	13.09%	1,757,785	1,600,000	9.86%
Korce	5,240,820	5,435,000	-3.57%	4,896,133	5,180,000	-5.48%	3,532,991	3,430,000	3.00%
Kukes	2,074,051	1,952,000	6.25%	2,024,108	1,882,000	7.55%	1,402,599	1,280,000	9.58%
Lezhe	3,438,400	3,555,000	-3.28%	3,354,016	3,465,000	-3.20%	2,232,975	2,240,000	-0.31%
Sarande	1,830,667	1,765,000	3.72%	1,748,769	1,680,000	4.09%	1,086,503	1,000,000	8.65%
Shkoder	5,485,549	5,730,000	-4.27%	5,302,947	5,380,000	-1.43%	3,742,707	3,860,000	-3.04%
Tirane	87,575,965	88,948,000	-1.54%	85,842,942	86,348,000	-0.58%	33,806,546	31,990,000	5.68%
DTM	88,708,521	96,740,000	-8.30%	78,293,249	83,340,000	-6.06%	22,182,121	21,570,000	2.84%
Vlore	5,038,051	5,005,000	0.66%	4,806,890	4,625,000	3.93%	3,079,655	2,980,000	3.34%
Total	235,499,428	246,480,000	-4.45%	218,987,896	225,480,000	-2.88%	94,116,872	90,900,000	3.54%

Tabela 3. Të ardhura nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (000 leke)

	Fakti TVSH		Plan TVSH		Ndryshimi %	
	neto	bruto	neto	bruto	neto	bruto
Berat	176,604	516,444	140,000	540,000	26.15%	-4.4%
Diber	(277,980)	345,962	285,000	455,000	-197.54%	-24.0%
Durres	835,060	1,858,684	550,000	2,250,000	51.83%	-17.4%
Elbasan	527,942	1,009,189	510,000	870,000	3.52%	16.0%
Fier	288,513	1,161,143	400,000	1,400,000	-27.87%	-17.1%
Gjirokaster	298,460	345,739	205,000	345,000	45.59%	0.2%
Korce	350,805	695,493	540,000	795,000	-35.04%	-12.5%
Kukes	239,462	289,404	205,000	275,000	16.81%	5.2%
Lezhe	464,284	548,668	500,000	590,000	-7.14%	-7.0%
Sarande	253,129	335,027	270,000	355,000	-6.25%	-5.6%
Shkoder	473,400	656,002	280,000	630,000	69.07%	4.1%
Tirane	12,133,923	13,866,946	11,325,000	13,925,000	7.14%	-0.4%
DTM	13,366,904	23,782,177	14,100,000	27,500,000	-5.20%	-13.5%
Vlore	532,787	763,948	350,000	730,000	52.22%	4.7%
Totali	29,663,293	46,174,825	29,660,000	50,660,000	0.01%	-8.9%

Tabela 4. Te ardhura nga Tatimi mbi Fitimin 12 Mujori (000 leke)

Tatimi mbi fitimin			
	Fakt	Plan	%
Berat	251,356	255,000	-1.43%
Diber	147,965	410,000	-63.91%
Durres	1,467,418	1,530,000	-4.09%
Elbasan	422,742	500,000	-15.45%
Fier	663,686	730,000	-9.08%
Gjirokaster	134,664	140,000	-3.81%
Korce	330,767	400,000	-17.31%
Kukes	119,804	135,000	-11.26%
Lezhe	262,377	280,000	-6.29%
Sarande	209,445	160,000	30.90%
Shkoder	342,022	390,000	-12.30%
Tirane	6,122,554	6,600,000	-7.23%
DTM	17,399,062	18,400,000	-5.44%
Vlore	484,932	460,000	5.42%
Totali	28,358,795	30,390,000	-6.68%

Tabela 5. Te ardhura nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale (000 leke)

	Fakt	Plan	%
Berat	373,151	420,000	-11.15%
Diber	354,874	450,000	-21.14%
Durres	1,632,966	1,950,000	-16.26%
Elbasan	796,341	870,000	-8.47%
Fier	846,566	890,000	-4.88%
Gjirokaster	395,099	325,000	21.57%
Korce	630,284	750,000	-15.96%
Kukes	255,080	250,000	2.03%
Lezhe	375,455	430,000	-12.68%
Sarande	185,790	240,000	-22.59%
Shkoder	704,564	820,000	-14.08%
Tirane	11,930,978	13,430,000	-11.16%
DTM	17,936,359	19,500,000	-8.02%
Vlore	651,656	755,000	-13.69%
Totali	37,069,163	41,080,000	-9.76%

Tabela 6. Krahاسimi TAP sipas zerave (000 leke)

		PLAN	FAKT	Diferenca FAKT-PLAN	
		2020	2020	+ ose -	Perqindje
	Tatimi mbi te ardhurat personale	41,080,001	37,069,163	(4,010,836)	-9.76%
1	Tatimi mbi page nga listepagesa	25,264,639	21,904,012	(3,360,627)	-13.30%
1,1	Nga te punesuarit e Sektorit Publik	9,130,263	8,441,668	(688,594)	-7.54%
1,2	Nga te punesuarit e Sektorit Privat	16,134,377	13,462,344	(2,672,033)	-16.56%
2	Tatim mbi te Ardhurat nga Interesat	2,744,491	2,148,666	(595,826)	-21.71%
3	Tatim mbi te Ardhurat nga Qerate	4,268,474	3,829,062	(439,412)	-10.29%
4	Tatim mbi Fituesit e Lodrave te Fatit	71,000	41,954	(29,046)	-40.91%
5	Tatim mbi A.Personale Biznesi Vogel me xhiro 2-8 mln leke	1,400	1,984	584	41.74%
6	Te tjera Tatime mbi te Ardhurat ne Burim	3,288,240	2,399,165	(889,076)	-27.04%
7	Tatimi mbi te ardhurat nga Dividentet dhe Aksionet	2,940,429	2,320,643	(619,786)	-21.08%
8	Tatim mbi te Drejten e Autorit dhe Pronesise Intelektuale	314,821	231,928	(82,893)	-26.33%
9	Tatimi mbi Deklaraten Individuale Vietore te te ardhurave	402,986	502,493	99,507	24.69%
10	Tatim, shitja e pasurise se paluajteshme	1,726,984	3,661,372	1,934,388	112.01%
11	Tatim, trashegimia dhe dhurimi	56,537	27,885	(28,652)	-50.68%

Tabela 7. Të ardhura nga Taksat Kombëtare dhe Tarifa (000 leke)

	Fakt	Plan	%
Berat	47,644	60,000	-20.59%
Diber	45,142	90,000	-49.84%
Durres	76,103	120,000	-36.58%
Elbasan	59,788	80,000	-25.27%
Fier	44,674	80,000	-44.16%
Gjirokaster	22,904	40,000	-42.74%
Korce	44,565	60,000	-25.73%
Kukes	5,603	12,000	-53.31%
Lezhe	16,088	15,000	7.25%
Sarande	10,042	10,000	0.42%
Shkoder	28,597	30,000	-4.68%
Tirane	4,753,618	5,167,000	-8.00%
DTM	6,703,608	7,780,000	-13.84%
Vlore	44,638	80,000	-44.20%
Totali	11,903,013	13,624,000	-12.63%

Tabela 8. Taksat Kombëtare dhe Tarifat sipas llojeve (përfshirë Tarifa Buxhetore)

Struk.	Lloji i te Ardhurave	FAKTET		PLANI	Diferenca FAKT 20-19	
		2019	2020	2020	+ ose -	Perqindje
A=B+C	TAKSAT dhe TARIFA NACIONALE	13,211,686	11,903,013	13,624,000	(1,308,672)	-9.91%
B	<i>Tarifa Kombetare</i>	953,174	777,411	1,013,000	(175,763)	-18.44%
C	Taksa Kombetare	12,258,511	11,125,602	12,611,000	(1,132,909)	-9.24%
	<i>Tarifa "BUXHETORE"</i>	4,114,093	3,037,772	0	(1,076,321)	-26.16%
1	8.Tarife sherbimi per Qarkullimin e	92,132	62,273	95,000	(29,859)	-32.41%
2	12.Tarife per rregjistrimin e Lojrave te Fatit ,	0	34,448	0	34,448	#DIV/0!
3	5. Tarife sherbimi per licensat radiotelevizive	16,386	14,743	18,000	(1,643)	-10.03%
4	2. Tarife sherbimi per perdorimin e	1,259,905	1,238,289	0	(21,616)	-1.72%
5	6. Tarife sherbimi per sherbimet e	469,915	474,567	0	4,652	1.0%
6	Takse nacionale per lejen e ushtrimit te	21,867	21,991	25,000	123	0.6%
7	Takse nacionale e karbonit per benzinen,	2,514,832	2,295,533	3,000,000	(219,299)	-8.72%
8	Takse nacionale per ambalazhet plastike te	2,210,654	1,998,475	2,327,000	(212,179)	-9.60%
9	Takse mbi te drejten e perdorimit te truallit	13,705	23,642	15,000	9,937	72.51%
10	Taksë mbi Primet e shkruara	1,167,459	1,270,311	1,300,000	102,852	8.81%
11	Taksa per regjistrim fillestar per automjete	119,123	127,896	156,000	8,773	7.36%
12	Taksa e pervitshme per automjetet luksoze	268,538	265,744	280,000	(2,795)	-1.04%
13	Takse per automjetet e perdorura te	4,091,900	3,915,927	4,257,000	(175,973)	-4.30%
14	9.Tarife sherbimi per kalimin e kufirit me	1,836,643	803,842	0	(1,032,801)	-56.23%
15	Taksa portuale	912	370	1,000	(542)	-59.44%
16	Taksa e Akteve dhe e Pulles	221,278	161,857	250,000	(59,421)	-26.85%
17	Taksa e rentes minerare	899,033	442,319	1,000,000	(456,714)	-50.80%
18	3 .Tarife per Sherbimet Konsullore	273,385	241,231	0	(32,153)	-11.76%
19	1.Tarife Per paisjen me Deshmi Aftesie per	274,246	279,842	0	5,597	2.04%
20	13. Tarife per Regjitrin ne arsimin e Larte	221,457	145,319	250,000	(76,139)	-34.38%
21	7. Tarifa per pasaporte lundrimi te	2,008	2,428	0	420	20.89%
22	4. Tarifa per aktet administrative	616,754	517,275	650,000	(99,479)	-16.13%
25	Tarife , gjoba, interesa	4,437	925	0	(3,512)	-79.16%
26	Taksa te tjera , gjoba, interesa	729,210	601,538	0	(127,671)	-17.51%
A+C	Gjithesej Taksa , tarifa nacionale + tarifa	17,325,779	14,940,785	13,624,000	(2,384,994)	-13.77%

Tabela 9. Të ardhura nga Taksa e Qarkullimit Rrugor (000 leke)

	Fakt	Plan	%
Berat	0	0	0.00%
Diber	0	0	0.00%
Durres	2	0	0.00%
Elbasan	0	0	0.00%
Fier	0	0	0.00%
Gjirokaster	0	0	0.00%
Korce	0	0	0.00%
Kukes	0	0	0.00%
Lezhe	0	0	0.00%
Sarande	0	0	0.00%
Shkoder	0	0	0.00%
Tirane	17,033,875	17,800,000	-4.30%
DTM	0	1,400,000	-100.00%
Vlore	0	0	0.00%
Totali	17,033,877	19,200,000	-11.28%

Tabela 10. Të ardhurat nga Sigurimet Shoqërore & Shëndetësore

	Fakt	Plan	%
Berat	2,244,680	2,270,000	-1.12%
Diber	1,901,750	1,950,000	-2.47%
Durres	8,165,852	7,930,000	2.97%
Elbasan	4,225,605	4,100,000	3.06%
Fier	4,755,100	4,700,000	1.17%
Gjirokaster	1,757,785	1,600,000	9.86%
Korce	3,532,991	3,430,000	3.00%
Kukes	1,402,599	1,280,000	9.58%
Lezhe	2,232,975	2,240,000	-0.31%
Sarande	1,086,503	1,000,000	8.65%
Shkoder	3,742,707	3,860,000	-3.04%
Tirane	33,806,546	31,990,000	5.68%
DTM	22,182,121	21,570,000	2.84%
Vlore	3,079,655	2,980,000	3.34%
Totali	94,116,872	90,900,000	3.54%

3. Sektori i Kontabilitetit dhe Pageses


Sektori i Kontabilitetit dhe Pageses monitoron funksionimin e sistemit të pagesave të detyrimeve tatimore dhe kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, me qëllim lehtësimin e procedurave të pagesës nga tatimpaguesit, lehtësimin e punës me bankat e nivelit të dytë për përgatitjen e informacionit në lidhje me këto pagesa dhe përmirësimin e përpunimit të të dhënave të pagesave për qëllime të administratës tatimore.


Sektori i Kontabiliteti dhe Pageses në përputhje me Objektivin e Planit Strategjik “Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare”– duke ofruar shërbime cilësore dhe duke ndikuar në reduktimin e barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore” ka mundësuar arritjen e rezultateve si më poshtë”:

1. Raportimin në kohë sa më të shpejtë i pagesave të arkëtuara në buxhetin e shtetit pranë Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Analizes si dhe strukturave drejtuese në DPT.
2. Identifikimin i pagesave pezull dhe sistemimi i tyre në llogarinë e duhur të tatimpaguesit.

Gjatë vitit 2020, ky sektor ka ndjekur, përgatitur dhe raportuar në kohë dhe me saktësi informacionin mbi pagesat e kryera në bankat e nivelit të dytë dhe në thesar lidhur me të ardhurat tatimore dhe kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Puna e kësaj drejtorie gjatë vitit 2020 është fokusuar në:

- Marrjen dhe Krahësimin e ekstraktit bankar me të dhënat e ardhura elektronikisht nga sistemi i thesarit.
- Komunikimin me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në funksion të mbarevajtjes së punës dhe saktësisë së informacionit. Numri i komunikimeve elektronike për zgjidhjen e problematikave të konstatuara gjatë vitit 2020 ka qenë rreth 122 dhe 23 komunikime për mosrakhordimin e raporteve të pageseve në e-Tax Helpdesk.
- Sistemimin e pagesave pezull në bazë të Akt-Marrëveshjes me Ministrinë e Financave dhe bankave të nivelit të dytë, duke komunikuar në mënyrë permanente me bankat e nivelit të dytë dhe me tatimpaguesit. Më saktësisht, janë sistemuar 1 140 raste për vitin 2020. Me poshtë paraqiten me grafik këto sisteme sipas muajve dhe sipas bankave.





Përgatitjen e raporteve ditore, mujore dhe progresive të të ardhurave tatimore dhe kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe për çdo Drejtori Rajonale Tatimore pas rakordimit të të ardhurave me bankat e nivelit të dytë dhe degën e thesarit si dhe vënien e këtyre raporteve në dispozicion të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Analizës dhe strukturave drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Gjatë vitit 2020 janë kryer 92 komunikime elektronike me bankat e nivelit të dytë dhe me tatimpaguesit për problematika të ndryshme.

- Komunikimin e vazhdueshëm me bankat e nivelit të dytë në zbatim të Akt-Marrëveshjes për të gjitha sqarimet për rastet e sistemimeve të pagesave që nuk mund të identifikohen nga Administrata Tatimore apo të ndonjë problemi të lindur gjatë zbatimit të kësaj akt marrëveshjeje me bankat e nivelit të dytë.

III. SHËRBIMI I TATIMPAGUESVE

1. Struktura e Drejtorisë

DPT- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

DSHT – Drejtoria e Shërbimit për Tatimpaguesit

DMB – Drejtoria e Menaxhimit të Borxhit

DMR – Drejtoria e Menaxhimit të Riskut

AT – Administrata Tatimore

SASH – Sektori i Asistencës dhe Shërbimit për Tatimpaguesit

SR – Sektori i Regjistrimit

QKB- Qendra Kombetare e Biznesit

QTH - Qendra e Thirrjeve

Si strukturë varësie, në DPT, DSHT është pjesë e Departamentit të Hartimit të programeve.

DSHT në DPT ka në përbërje 3 sektorë:

Sektori i Shërbimit dhe Asistencës për Tatimpaguesit (SASH) me përbërje 1 përgjegjës + 2 specialistë,

Sektori i Regjistrimit (SR) me përbërje 1 përgjegjës + 2 specialistë dhe

Qendra e Thirrjeve (QTH) me përbërje 1 përgjegjës + 12 specialistë.

Numri total i punonjësve 20 (1+3+16).

DSHT është përgjegjëse, për sigurimin e ofrit të shërbimit cilësor dhe asistencës për të gjithë tatimpaguesit, për menaxhimin e regjistrimit të tatimpaguesve përfshirë azhurnimet e tij, me qëllim përmbushjen vullnetare të detyrimeve ligjore si dhe zhvillimin dhe konsolidimin e modelit GoAutoDial për komunikim me personat tatimpagues, bashkëpunimin ndërmjet Administratës Tatimore dhe publikut të gjerë për realizimin e objektivit të përbashkët në mbledhjen e të ardhurave publike në mënyrë vullnetare dhe me kosto efektive.

Sektori i Asistencës dhe Shërbimit

- Harton Plan Komunikimi me objektiv të përcaktuar (fushata informuese), me qëllim informimin dhe ndërgjegjesimin e tatimpaguesve.

- Bashkëpunon me Drejtorite në DPT për përgatitjen e materialeve informuese për tatimpaguesit.
- Përditëson materialet e faqes së internetit të DPT, tatime.gov.al (Legjislacioni tatimor, kalendari etj)
- Ndjek zgjidhjen e problematikave të shfaqura nga tatimpaguesit për deklarin elektronik, e-filing, etj.
- Ndjek ofrimin dhe implementimin e shërbimeve të DPT në portalin e-Albania.
- Merr informacion nga Drejtoritë Rajonale për plotësimin e detyrave të Shërbimit.

Sektori i Regjistrimit:

- Mbikqyr përditësimin e regjistrave të tatimpaguesve.
- Bashkëpunon me QKB për regjistrimin e bizneseve te reja.
- Në bashkëpunim me Drejtorinë e TI në DPT mbajnë të azhurnuar marrëveshjen dhe protokollin elektronik të shkëmbimit të të dhënave midis QKB dhe DPT.
- Ndjek zgjidhjen për kërkesat e tatimpaguesve të cilët hasin vështirësi teknike në pasqyrimin e të dhënave reale te tyre.
- Mbikqyr dhe merr informacion nga Drejtoritë Rajonale për funksionin e Regjistrimit.

Qendra e Thirrjeve

- Garanton zgjerimin e komunikimit elektronik me tatimpaguesit për përmbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore, informimi i tyre, për lehtësimin e procedurave administrative dhe përjashtimin e disa veprimtarive nga taksimi me synim zhvillimin e disa sektorëve të veçanta si inovacioni, bujqësia, turizmi e agroturizmi etj, të stimuluar nga ndryshimet ligjore.
- Komunikon me tatimpaguesit në lidhje me zbatimin e drejtë të legjislacionit tatimor dhe zhvillimin e kapaciteteve administrative.
- Zgjeron ofrimin e shërbimeve të reja e cilësore nëpërmjet sistemit TI të instaluar, për zbatimin e legjislacionit tatimor që lidhet me komunikimin dhe reduktimin e kostove administrative për mbledhjen e taksave.

2. Objektivat e Drejtorisë për vitin 2020

Gjatë vitit 2020, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesit sipas Planit operacional ka performuar 19 aktivitete gjithsej, nga të cilët 17 janë Aktivitete në zbatim të Objektive Strategjike.

Në kuadër të rekomandimeve të lëna nga FMN këtë vit janë zbatuar 10 aktivitete, si edhe në kuadër të rekomandimeve të lëna nga TADAT ishin 2 aktivitete.

Aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2020 janë bazuar në përmbushjen e dy nga objektivat e **planit strategjik**:

Objektivat strategjike

I. Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare

- 1.1 Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe reduktimi i barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore.
- 1.2 Rritja e ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë dhe kuptimin e rolit të Administratës Tatimore në shoqëri.
- 1.3 Rritja e ndërgjegjësimit të Tatimpaguesve.
- 1.4 Zbatimi i metodologjive dhe praktikave njëhsuese.

II. Implementimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore

- 2.1 Zbatimi i strategjisë së përmbushjes së menaxhimit të riskut.
 - Zhvillimi dhe konsolidimi i modelit GoAutoDial për komunikim me personat tatimpagues, bashkëpunimi ndërmjet Administratës Tatimore dhe publikut të gjerë për realizimin e objektivit të përbashkët në mbledhjen e të ardhurave publike .
 - Hartimi i strategjisë së përgjithshme për përfshirjen e funksioneve të Qendrës së Thirrjeve, si pjesë e integruar e shërbimit ndaj tatimpaguesve.
 - Zgjerimi dhe konsolidimi i ofrit të shërbimeve cilësore me sistemin GoAutoDial, për zbatimin e legjislacionit tatimor dhe reduktimin e kostove administrative

3. Treguesit kryesore të performancës

- **Numri i njoftimeve** i dërguar tatimpaguesve me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar.
- **Numri i takimeve të mbajtura** me tatimpaguesit me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar.
- **Numri total i vizitave këshilluese** të përfunduara.
- **Numri i seminareve edukues** të realizuar.
- **Numri total i taksapaguesve i asistuar (ballë për ballë)**

Numri i njoftimeve i dërguar tatimpaguesve me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar.	220 051
--	----------------

Numri i takimeve të mbajtura me tatimpaguesit me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar.	272
Numri total i vizitave këshilluese të përfunduara	17 685
Numri i seminareve edukues të realizuar	367
Numri total i taksapaguesve i asistuar (ballë për ballë)	172 678

4. Aktivitet e programuara dhe realizuara gjatë vitit 2020 në funksion të realizimit të objektivave.

- ✓ Evidentimi i listës së institucioneve për hartim të marrëveshjes së bashkëpunimit.
- ✓ Propozime për ndryshime në Udhëzimin nr.24, datë 2.9.2008 "Për procedurat tatimore". Shkurt 2020 – miratuar Shkurt 2020.
- ✓ Realizimi i anketimit për Web për tatimpaguesit - 10-29 Shkurt.
- ✓ Nëntor 2020 e në vijim, po zhvillohet një anketim në Web dhe e-filing, mbi kënaqësinë e tatimpaguesve për masat e marra nga AT gjatë periudhës COVID-19.
- ✓ Komunikim me personat që kanë detyrim ligjor për DIVA dhe detyrimet e papaguara në afat.
- ✓ Informimi nëpërmjet komunikimit me thirrje dalëse për të gjitha shoqëritë tregtare të regjistruara me xhiro vjetore mbi 50 milion lekë, kryesisht aksionarët e tyre.
- ✓ Evidentuar lista e tatimpaguesve që kanë aplikuar 6% për strukturat akomoduese; verifikimi i tyre me listën e Ministrisë së Turizmit mbi ato që kanë aplikuar, si dhe janë njoftuar për shtyrjen e afatit të aplikimit deri në datë 31.03.2020. -Mars 2020. Njoftimi është publikuar gjithashtu në web dhe e-filing.
- ✓ Përgatitja e kërkesave të përdoruesit për zhvillimet në sistem sipas ndryshimeve në Udhëzimin nr.24. - Prill 2020.
- ✓ Ndjekja e zbatimit të Marrëveshjes me QKB, realizuar:
 - a. Ndjekja e zbatimit të marrëveshjes QKB-DPT dhe Protokollit elektronik të komunikimit për shkëmbimin e të dhënave për transmetimin e të dhënave të tatimpaguesve, për regjistrimet e reja dhe ndryshimeve në regjistrim - Realizuar
 - b. Ndjekja e Pasqyrit në regjister i të gjitha veprimeve që kryejne përdoruesit në DRT, për regjistrimet e reja dhe ndryshimeve në regjistrim, për Tp., që regjistrohen në AT – Realizuar

c. Mbikqyrja e veprimeve qe bejne DRT ne regjistrin e Tatimpaguesve per, - ndryshimin e pergjegjesive tatimore,- statusit te Tp., etj.. Zgjidhje e problemeve qe ngecin duke bashkepunuar me palen furnitore – Realizuar

d. Monitorimi i marrjes se informacionit nga QKB per shoqerite qe likujdohen, bashkohen , ndahen, bazuar ne zhvillimet e reja qe jane bere ne Sistem per marrjen e ketij informacioni ne dobi te DRT-ve - Realizuar pjeserisht

Nuk pergjigjet QKB, po kryhen zhvillime ne sistemin e saj -. Nga takimet e zhvilluara me QKB, eshte vijuar me zhvillimet, per dergimin e te dhenave ne lidhje me shoqerite qe likujdohen, bashkohen apo ndahen, nga Pala e tyre mirembajtese. Ne pritje te dergimit te te dhenave nga QKB.

- Trajnim i stafit për ndryshimet ligjore, si dhe për Fiskalizimin. Për shkak të situatës Covid-19, trajnimet janë organizuar nga DBNJ.
- Shërbime të reja DPT në platformën e-albania - realizuar pjesërisht: ofrohet ‘Rivendosje Fjalëkalimi’. Në Nëntor 2020 përfundoi procesi i testimit për shërbimin Njoftimi i të dhënave të regjistrimit, në pritje për t'u mundësuar implementimi live. Ndërkohë jemi në pritje që pala mirëmbajtëse të mundësojë zhvillimin e testimeve për:
- Njoftimi ndryshimeve në regjistrim.
- Certifikatë rezidence për individë
- Trajnimet per tatimpaguesit ne cdo DRT:

1. Ne datat 3 shkurt - 10 mars, sipas kalendarit te publikuar ne web dhe FB, eshte zhvilluar faza e pare e trajnimeve ne DRT, per tatimpaguesit, per “Ligjin per faturen dhe sistemin e monitorimit te qarkullimit”, me pjesemarres kontabiliste, studio kontabiliteti, tatimpagues dhe perfaqesues te tyre. 239 seanca trajnimi, me 2886 pjesemares, te cilet perfaqesojne 7893 subjekte. Trajnues jane trajneret lokale te trajnuar me pare.

2. Tetor 2020, jane organizuar 45 takime prezantuese per entet publike ne DRT

3. Nentor – Dhjetor jane zhvilluar trajnimet B2G, per tatimpaguesit dhe entet publike ne DRT. Në trajnime morën pjesë rreth 5.655 pjesëmarrës, të cilët përbëjnë 67 % të totalit prej 8.446 tatimpaguesve (ente publike dhe subjekte private), të identifikuar për t'u trajnuar.

Ente publike total: 1.334

Trajnuar: 863 (65% e totalit)

Per t'u trajnuar: 471 ose 35% e totalit

Tatimpagues total: 7.112

Trajnuar: 4.792 (67% e totalit)

Per t'u trajnuar: 2.320 (33% e totalit)

Gjatë vitit 2020 jane realizuar thirrje (SHËRBIME ELEKTRONIKE ME SISTEMIN GoAutoDial) si me poshte :

❖ <i>Komunikim me thirrje hyrëse</i>	83,886
❖ <i>Komunikim me thirrje dalëse</i>	53, 137
Thirrje gjithsej	137,023
❖ Komunikimi ne Live Chat	3,590
❖ E-maile të ndryshme	98
Komunikime gjithsej	140,711

Krahasuar me vitin 2019, janë kryer 23.1 % më tepër komunikime duke realizuar zotimet e parashikuara në objektivat e DSHT, konkretisht:

64 Fushat Komunikimi

32 në bashkëpunim me DMB

32 në bashkëpunim me DMR, DSHT.

4.1 Aktivitete jo të parashikuara në planifikimin fillestar, por të realizuara gjatë vitit 2020

- Në kuadër të situatës COVID-19: përgatitje njoftimesh për web, FB dhe e-filing, udhëzues për aplikim për paktetat e ndihmës financiare, trajtim i ankesave, ndjekje dhe raportim për ankesat në DRT etj

4.2 Aktivitete të përzehuara ose të përfunduara (arsyet dhe afatet e përfundimit)

- Marrja e të dhënave të QKB dhe krahasimi i tyre me ato që janë ngarkuar në sistemin e DPT lidhur me regjistrimet e reja dhe kalimet në Pasiv është realizuar pjesërisht. QKB po kryen zhvillime në sistemin e saj.
- Hartuar Plani i Komunikimit për paketën fiskale 2020 dhe realizuar pjesërisht: përditesimi i legjislacionit tatimor në fuqi, publikimi i ndryshimeve ligjore, njoftimi i stafit etj.
- Për shkak të emergjencës COVID-19, zbatimi i Planit të Komunikimit për Informalitetin në punë (Sherbimi në DRT u angazhua për dërgimin e njoftimeve për punëdhënësit dhe punëmarresit, nuk u realizuan takimet në DRT).
- Hartuar Plani i Komunikimit për sezonin turistik. Realizuar njoftime, takime informuese në DRT, vizita në subjekte nga sektori shërbimi.
- Hartim i metodologjisë për Anketimet dhe pyetësoret (kërkese për bashkëpunim me palën suedeze)
- Nuk u arrit të përfundonin dy shërbime online në portalin e-albania në lidhje me regjistrimin online për t.p. që regjistrohen në AT dhe ndryshimet në regjistrim. Ndërsa janë bërë të gjitha zhvillimet bazë për këtë proces arsyet e mosfinalizimit janë:

- a- probleme sigurie gjate regjistrimit nga ana e individeve te cilet duhet te regjistrojne vetem veten e vet por dhe disa probleme sigurie me personat Juridike.
- b- ngarkesat qe ka patur pala mirembajtese gjate vitit 2020

4.3 Sa dhe si ndikuan keto aktivitete ne arritjen e objektivave te percaktuara.

Mosrealizimi i aktiviteteve te mesiperme nuk ka ndikuar ne realizimin e objektivave te percaktuara per DSHT.

4.4 Problematikat e hasura gjate realizimit te aktiviteteve gjate vitit 2020

Plotesimi i struktures se DSHT – ne DSHT. Pozicioni i Drejtorit te Drejtorise eshte plotesuar ne muajin tetor 2020 dhe 2 punonjese te angazhuara ne Grupin e punes per Fiskalizimi gjate 2020.

IV. PERFORMANCA TEKNIKO-LIGJORE

1. HYRJE

Objektivi kryesor i punës së Drejtorisë Teknike Dhe Ligjore siç është përcaktuar edhe në Rregulloren e Administratës Tatimore Qendrore është garantimi dhe zbatimi me paanshmëri i ligjit në mënyrë të tillë që çdo akt administrativ dhe dokument zyrtar që del nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të jetë i mbështetur në Legjislacionin Tatimor dhe ligjet e tjera të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

1.1 Detyrat kryesore të Drejtorisë Teknike dhe Ligjore janë:

- Bashkëpunimi dhe koordinimi me drejtoritë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe me DRT, i procesit për evidentimin dhe nevojën për ndryshime ligjore, si dhe hartimi e dërgimi i propozimeve përkatëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;
- Përgatitja dhe bashkërendimi në formulimin e projekt-vendimeve, urdhrave apo qarkoreve për probleme teknike dhe ligjore të zbatimit të legjislacionit tatimor për t'u miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme;
- Bashkëpunimi në hartimin e projekt-planeve strategjike të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- Bashkërendimi i punës dhe ndjekja e të gjitha proceseve gjyqësore ku Administrata Tatimore është palë si dhe asistimi me ndihmë juridike i Drejtorive Rajonale në pjesëmarrjen e tyre në proceset gjyqësore;
- Kthimi i përgjigjeve për të gjitha rastet kur kërkohet interpretim ligjor, vetëm ose në bashkëpunim me struktura të tjera të autorizuara;
- Interpretim i procedurave tatimore, TVSH, Tatimet Direkte dhe Marrëveshjet e Eliminimit të Taksimit të Dyfishtë.
- Angazhimi në dhënie mendimi ligjor dhe teknik për çdo projektligj, draft-marrëveshje, apo çështje të tjera të karakterit ligjor\teknik;
- Zbatimi i çdo detyre tjetër, që i ngarkohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm.

Në kuadër të realizimit të detyrave të mësipërme dhe planit strategjik 2017-2021, DTL ka synuar t'i përmbahet vizionit për ofrimin e një Administrate Tatimore moderne dhe efikase në shërbim të tatimpaguesve, për të garantuar një nivel të lartë të transparencës dhe modernizimit të shërbimeve në zbatim të legjislacionit tatimor.

1.2 Organizimi i Drejtorisë Teknike dhe Ligjore

Drejtoria Teknike dhe Ligjore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është e organizuar dhe funksionon si vijon:

1. Sektori i Çështjeve Ligjore (1+5) ku aktualisht 1 pozicion pune “*specialist*” dhe 1 pozicion pune përgjegjës janë vakante;
2. Sektori i TVSH-së dhe taksave të tjera (7+1) ku aktualisht 4 pozicione pune “*Inspektor i parë*” janë vakante;
3. Sektori i Taksave direkte (7+1) ku aktualisht 1 pozicion pune “*Inspektor i parë*” është vakant.

2. OBJEKTIVAT E DREJTORISË PËR VITIN 2020

2.1. Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare:

- ✓ Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe reduktimi i barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore;
- ✓ Bashkëpunimi me drejtoritë përkatëse për dhënien e një informacioni të bazuar në ligj, të qartë dhe të kuptueshëm;
- ✓ Hartimi i draft-ligjeve dhe akteve nënligjore për Shkëmbimin Automatik të Informacionit;
- ✓ Hartimi i draft-ligjeve dhe akteve nënligjore në fushën e monitorimit të transaksioneve cash;

2.1.2 Rritja e ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë dhe kuptimin e rolit të Administratës Tatimore në shoqëri.

- ✓ Trajtimi në kohë i çdo njoftimi, sinjali apo propozimi që lidhet me aktivitetin e AT.

2.1.3 Zbatimi i metodologjive dhe praktikave njehsuese:

- ✓ Dhënia e mendimeve për çdo ndryshim ligjor që do të propozohet lidhur me legjislacionin tatimor. Hartimi i propozimeve për ndryshime ligjore të iniciuara nga AT;
- ✓ Hartimi i komentareve përmbledhës të vendimeve teknike, të grupuara sipas natyrës së tyre.
- ✓ Përcjellja periodikisht për publikim i opinioneve që japin qëndrime për zbatimin e legjislacionit tatimor.
- ✓ Përgatita e buletineve informuese lidhur me vendimet e formës së prerë të gjykatave, shoqëruar me një analizë të vendimarrjes së tyre.
- ✓ Marrja e masave për përfaqësimin cilësor në konfliktet gjyqësore, përgatitjen e provave dhe prapësimeve etj.
- ✓ Kontrolli në vazhdimësi i përmbushjes së detyrave funksionale, nëpërmjet inspektimeve në çdo DRT.

Progresi Organizativ i Administratës Tatimore dhe Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore

Aplikimi i metodave dhe sistemeve për të menaxhuar një AT modern

- ✓ Pjesëmarrja në trajnime apo takime me përfaqësues të administratave homologe më qëllim shkëmbimin e eksperiencave.

2.2.2 Zhvillimi i kapaciteteve dhe motivimi i punonjësve

- ✓ Ndarja racionale e detyrave brenda Drejtorisë;
- ✓ Vlerësimi objektiv i punonjësve sipas meritës dhe aftësive.

2.2.3 Zhvillimi dhe përmirësimi i partneriteteve

- ✓ Trajtimi me përgjegjshmëri i problematikave lidhur me marrëveshjet ekzistuese; Hartimi i draft-marrëveshjeve sipas nevojave institucionale;
- ✓ Trajtimi dhe dhënia e opinionit për draft-marrëveshjet e propozuara nga institucionet e tjera.

3. AKTIVITET E PROGRAMUARA DHE REALIZUARA GJATË VITIT 2020 NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË OBJEKTIVAVE

Duke pasur parasysh organizimin e strukturës së Drejtorisë Teknike dhe Ligjore raportimi mbi rezultatet dhe veprimtarinë e saj për vitin 2020 do të pasqyrohet në 3 ndarje kryesore sipas sektorëve përkatës, përkatësisht: Sektori i Çështjeve Ligjore, Sektori i TVSH dhe taksave të tjera dhe Sektori i Taksave Direkte.

3.1 SEKTORI I ÇËSHJTJEVE LIGJORE

Sektori i Çështjeve Ligjore është krijuar me strukturën e re të AT (përpara ndryshimeve strukturore ka qenë Sektori i Çështjeve Tatimore dhe Sektori i Çështjeve Jo-tatimore duke patur kompetenca dhe funksione të ndara). Për këtë arsye në vijim do të paraqitet veprimtaria e Sektorit të Çështjeve Tatimore, për periudhën Janar- Gusht 2020.

Për periudhën Janar-Gusht 2020 ky sektor ka ofruar shërbim ligjor, konsulencë dhe asistencë juridike, si për Drejtoritë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtoritë Rajonale Tatimore ashtu dhe për tatimpagues të ndryshëm, nëpërmjet:

- **Dhënies së opinionit ligjor** për çështje dhe problematika të hasura në praktikë, për të cilat është kërkuar mendim nga strukturat ligjzbatuese në DPT apo Drejtoritë Rajonale Tatimore. Sektori i Çështjeve Ligjore ka bashkëpunuar me drejtoritë përkatëse për dhënien e një informacioni të bazuar në ligj, të qartë dhe të kuptueshëm, në mënyrë që të garantohet asistencë teknike dhe ligjore për tatimpaguesin. Për të zbatuar dhe ndjekur praktika të njësuara lidhur me lehtësimin e procedurave

tatimore janë udhëzuar strukturat e Administratës Tatimore me anë të udhëzuesve të ndryshëm, si dhe janë dërguar rreth 18 opinione ligjore ndaj strukturave të administratës tatimore lidhur më çështje specifike të cilat janë analizuar rast pas rasti;

- **Garantimit të asistencës teknike dhe ligjore për tatimpaguesit** për të siguruar një informacion të plotë, të kuptueshëm dhe të aksesueshëm në kohë.
- **Dhënies së mendimit dhe draftimin e akteve të lidhura** me procesin e vendimarrjes mbi drejtime të caktuara të veprimtarisë së Administratës Tatimore. Gjatë vitit 2020 janë përcjellë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë zyrtarisht rreth 10 propozime për ndryshime në legjislacionin tatimor në fuqi, që cekin pothuajse të gjithë kuadrin ligjor të ligjeve tatimore.
- Ofritit të konsulencës ligjore në hartimin e projekt-akteve, nëpërmjet koordinimit, studimit, ofritit të opinioneve juridike dhe pjesëmarrjes në grupet e punës, sa herë që kërkohet brenda afateve ligjore.
- **Asistencës ligjore** për bashkërendimin e punës me të gjitha njësitë brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale, për zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore në ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Për këtë funksion janë hartuar rreth 5 akte rregullatore, për funksionimin konform ligjit për strukturat e DPT-së, rreth 10 rregullore si dhe mbi 50 urdhra të brendshëm.
- Me qëllim përmbushjen e detyrave të saj dhe ofrimin e bashkëpunimit Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në rrugë zyrtare ka shkëmbyer me institucionet e tjera, përfshirë edhe MFE, rreth 120 shkresa të hartuara nga Sektori i Çështjeve Ligjore.
- Ka marrë pjesë në:
 - ✓ Komisione apo grupe pune të ndryshme të caktuara me urdhër të titullarit;
 - ✓ Komisionet e Vlerësimit të Ofertave apo njësitë e Prokurimit për procedurat e prokurimeve të zhvilluara nga institucioni.
- Përgatitjes së Buletineve të Vendimeve Gjyqësore që përmbledhin vendimet e formës së prerë të Gjykatave të Shkallës së Parë, Gjykatave Administrative të Apelit, Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese për çështjet tatimore, me qëllim informimin e tatimpaguesve.
- **Mbledhja e opinioneve bazuar në fenomenet/problematikat e hasura nga strukturat e Kontrollit/Hetimit/Borxhit/Regjistrimit**

Janë dërguar pranë MFE propozimet për ndryshime ligjore të propozuara nga drejtoritë në DPT - "Propozime për ndryshime në VKM nr. 953 datë 29,12,2014 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe me - "Propozim për disa ndryshime në ligjin nr.9920 datë 19,05,2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

- **Proceset gjyqësore:**

Specialistët e Sektorit të Çështjeve Ligjore në DPT përfaqësojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në të gjitha konfliktet gjyqësore ku ajo është palë ndërgjyqëse. Për vitin 2020 specialistët/juristët e Drejtorisë Teknike dhe Ligjore kanë përfaqësuar DPT-në të gjitha konfliktet gjyqësore të deleguara sipas rastit, me palë paditëse ish-punonjës të kontraktuar nga administrata tatimore, bazuar në dispozitat e Kodit të Punës apo nëpunës civilë të konfirmuar.

Janë marrë masat për të garantuar përfaqësimin në çdo proces gjyqësor ku pala ndërgjyqëse ka qënë DPT, gjatë vitit 2020 kemi gjithsej 226 çështje të lidhura me marrëdhënien e punës.

1. Në Gjykatat Civile gjatë vitit 2020 janë gjykuar, dhe po gjykohen 126 konflikte gjyqësore me palë paditëse ish-punonjës të kontraktuar me kontratë punësimi nga të cilat:
 - 4 raste janë Vendime të formës së prerë.
 - 15 raste janë Vendime të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore, vendime për të cilat është ushtruar e drejta e ankimit në Gjykatën Civile të Apelit.

Gjykatat Administrative gjatë vitit 2020 kanë patur në trajtim 86 konflikte gjyqësore me palë paditëse ish-nëpunës civilë të konfirmuar nga të cilat:

- 10 raste janë Vendime të formës së prerë.
- 19 raste janë Vendime të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë, ku pala e paditur ka qënë Drejoria e Përgjithshme e Tatimeve.
- 2 raste janë Vendime të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë, ku pala paditëse ka qënë Drejoria e Përgjithshme e Tatimeve,

Janë përgatitur 2 Buletine të Vendimeve Gjyqësore, përkatësisht për periudhat Janar - Qershor 2020 dhe Korrik- Dhjetor 2020.

Detyra të tjera të realizuara nga Sektori i Çështjeve Ligjore:

- Ka garantuar trajtimin e praktikave për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, konform legjislacionit në fuqi:
- Janë ndjekur dhe vlerësuar praktikat e ardhura në DPT nga Zyrat e Përmbartimit apo kërkesa individuale për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe ka përgatitur të gjitha praktikat e ardhura për trajtim si dhe përcjelljen për veprime të mëtejshme strukturave kompetente.

Detyra të tjera të përmbushura nga Sektori i Çështjeve Ligjore:

Marrëveshjet me institucione të tjera.

Përgjatë vitit 2020 janë konkluduar nga ana e Drejtorisë Teknike dhe Ligjore 5 marrëveshje bashkëpunimi:

- 1- Marrëveshje Bashkëpunimi “Për Shkëmbimin e Informacionit midis dy Institucioneve në Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit” midis BKH dhe DPT.
- 2- Draft-Marrëveshje Bashkëpunimi midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit “Për Shkëmbim Informacioni dhe dhënien e të drejtës së konsultimit në bazën e të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”.
- 3- Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet DPT dhe OSHEE “Për bashkëpunim ndërinstitucional me qëllim shkëmbimin e informacionit”.
- 4- Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Tatim Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë “Për bashkëpunimin ndërinstitucional me qëllim shkëmbimin e informacionit”.
- 5- Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet DPT, MFE dhe Ministrisë së Brendshme “Për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare dhe sekuestrimin e konfeskimin e aseteve kriminale, në funksion të përmbushjes të KSA-së e FATF dhe Planit të Veprimit ICRG/FATF.

Sektori Ligjor ka trajtuar në total mbi 1280 shkresa.

3. 2 ÇËSHTJET TEKNIKE

Sektori Teknik ka trajtuar dhe asistuar me shpjegime dhe opinione teknike, duke iu përmbajtur dispozitave ligjore tatimore, strukturat e brendshme të Administratës Tatimore, po ashtu edhe një numër të konsiderueshëm çështjesh të ardhura për sqarime tekniko-ligjore në adresë të DPT-së.

Është angazhuar në grupe pune, ka bashkëpunuar me strukturat e tjera si dhe ka përcjellë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë çështje, të cilat kanë patur nevojë për një opinion më të zgjeruar.

Gjatë vitit 2020 në Sektorin Teknik janë realizuar objektivat lidhur jo-vetëm me funksionet kryesore të sektorit, por edhe detyra të tjera të lindura nga nevojat për ndryshime të ligjeve fiskale dhe në përputhje me politikat fiskale të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Bazuar në objektivin e sektorit lidhur me hartimin dhe zbatimin e opinioneve metodologjike të përditësuara dhe në vazhdimësi për zbatimin uniform të legjislacionit, janë përgatitur qëndrimet zyrtare të DPT lidhur me problematika të ndeshura në praktikë.

Sektori Teknik ka trajtuar 966 shkresa, duke siguruar një informacion të plotë, të kuptueshëm në kohë dhe të aksesueshëm në lidhje me përmbushjen tatimore.

Volumin më të madh (85%) e mbulojnë kërkesat për interpretim të cilat i japin një shtysë vetëpërmbushjes nga ana e tatimpaguesve dhe administratës tatimore gjithashtu.

➤ Trajtimi i ankesave të ardhura nga Platforma e Bashkëqeverisjes si një praktikë efikase ndërveprimi me qytetaret.

- Gjatë vitit 2020 janë trajtuar mbi 2102 ankesa në bashkëpunim edhe me strukturat e tjera të administratës tatimore, duke patur si synim kryesor që të mundësohet dhënia e përgjigjeve për ankuesit brenda afateve të përcaktuara.

Ndër të cilat:

- 1691- ankesa qytetarësh
- 411- ankesa biznesi
- 2102- ankesa gjithsej.

➤ Është përgatitur Buletini i Vendimeve Gjyqësore, për periudhat Janar - Qershor 2020 dhe Korrik-Dhjetor 2020 vitin 2020.

➤ **Përgatitja e propozimeve nënligjore në kuadër të projektit të fiskalizimit, udhëzime dhe VKM-të.**

Lidhur me fiskalizimin janë miratuar aktet ligjore dhe nënligjore si më poshtë:

1. Ligji Nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.
2. VKM Nr. 220, datë 12.03.2020 “Për përcaktimin e kategorisë së tatimpaguesve dhe kriteret e përdorimit të procedurës së thjeshtëzuar të fiskalizimit”.
3. VKM Nr 239, date 20.03.2020 “Për kërkesat teknike dhe funksionale të zgjidhjes software-ike për procedurën e faturimit dhe fiskalizimit dhe procedurën dhe kriteret për regjistrimin e prodhuesve dhe mirëmbajtësve të zgjidhjeve software-ike”.
4. Udhëzimi Nr. 16, datë 03.04.2020 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.
5. VKM Nr. 431, datë 03.06.2020 “Për platformën qendrore të faturave”.
6. Udhëzim Nr. 20, datë 01.06.2020 “Për elementet bazë dhe teknike, lëshimin dhe shkëmbimin e faturave elektronike dhe faturave shoqëruese”.
7. Udhëzim Nr. 24, datë 16.06.2020 “Për regjistrimin e pagesave të faturave elektronike”.

➤ **Dhënia e opinioneve për çdo ndryshim ligjor që do të propozohet lidhur me legjislacionin tatimor. Hartimi i propozimeve për ndryshime ligjore të iniciuara nga AT.**

- Në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, janë reflektuar ndryshime lidhur me garantimin e mirëmbajtjes së paisjeve fiskale, gjithashtu është bërë një ndryshim në nenin 122 lidhur me heqjen e masës së bllokimit përpara afatit 30 ditor nëse tatimpaguesi paguan dënimin.
- Është dhënë kontribut në hartimin e draft VKM për dhënie ndihme financiare, si vijon:

- VKM nr.254, datë 27.3.2020 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19”.
- VKM nr. 305, datë 16.4.2020 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e COVID-19”;
- VKM nr. 856, datë 4.11.2020 “Për Ndihmën Financiare të disa prej kategorive kryesore të ndërmarrjeve, të cilat zbatojnë Protokollin e Sigurisë, në kuadër të Parandalimit e të Kontrollit të Pandemisë COVID-19”;
- VKM nr.651, datë 13.8.2020 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare, si pasojë e COVID-19, për të punësuarit apo ish-të punësuarit në subjektet e transportit publik qytetas dhe ndër-qytetas.
- VKM nr. 909, datë 18.11.2020 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për punonjësit dhe ish-punonjësit e Rafinerisë së naftës, Ballsh".

3.3 SEKTORI I TAKSAVE DIREKTE

Pas ristukturimit të strukturës organizative së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorise Teknike dhe Ligjore iu shtua një sektor i ri “**Sektori i Taksave Direkte**”.

Ky sektor ka këto detyra kryesore:

- 1- Trajtimi i shkresave me qëllim zbatimin e marrëveshjeve tatimore për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal.
- 2- Certifikatat e Rezidencës Tatimore.
- 3- Shkëmbimin e informacionit me Autoritetet e Huaja Tatimore (EOIR).
- 4- Interpretime në lidhje me Tatimin mbi të Ardhurat dhe Tatim Fitimin.

Në total gjatë kësaj periudhe (27.07.2020 – deri në 31.12.2020) në Sektorin e Taksave Direkte kanë hyrë 1536 shkresa ku nga këto kanë marrë trajtim 1111 shkresa (rreth 73% e tyre).

Në lidhje me aplikimet për certifikatat e rezidencës, individët dhe tatimpaguesit me administrator të huaj aplikojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për pajisje me Çertifikatë Rezidence Tatimore, me qëllim tatimin e të ardhurave globale në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë kësaj periudhe kemi 118 aplikime të reja. Nga këto 118 aplikime:

- 83 prej tyre pra rreth 70% janë pajisur me certifikaten e rezidences ku 19 janë subjekte dhe 64 janë individë.
- Pjesa tjetër nuk kanë plotësuar kushtet për t'u pajisur me certifikatë dhe janë në proces të plotësimit të dokumentacionit.

Aplikime për zbatimin e marrëveshjeve për eliminimin e taksimit të dyfishtë janë 711 aplikime.

Rreth 250 shkresa janë plotësime dokumentacioni për mosplotësim të kërkesave të udhëzimit nr.6, datë 10.02.2004, “Për Marrëveshjet Bilaterale për Shmangien e Taksimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal”.

Një nga detyrat e Sektorit të Taksave Direkte është dhe shkëmbimi i informacionit me administratat e tjera tatimore me qëllim zbatimin e marrëveshjeve tatimore për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe për parandalimin e evazionit fiskal. Gjatë kësaj periudhe janë kryer shkëmbime të iniciuara nga ne në rastet e dyshimeve për deklarimin apo jo të të ardhurave të tatimpaguesve por edhe shkëmbime të iniciuara nga shtetet e huaja që kërkojnë informacione të ndryshme (psh: për adresën e saktë të tatimpaguesit qoftë individ apo subjekt, të dhëna për llogaritë bankare, informacione për trashëgimtarët, për bizneset që mund të kenë në Republikën e Shqipërisë etj.)

Shkëmbime informacioni të iniciuara nga Sektori i Taksave Direkte janë 9, si vijon:

- 2 shkëmbime me shtetin e Greqisë;
- 1 shkëmbim me shtetin e Italisë;
- 1 shkëmbim me shtetin e Estonisë;
- 1 shkëmbim me shtetin e Hungarisë;
- 2 shkëmbime me shtetin e Francës;
- 1 shkëmbim me shtetin e Kinës.
- 1 shkëmbim me shtetin e Austrisë.

Shkëmbime informacioni të iniciuara nga shtetet e huaja janë 11, si më poshtë:

- 5 shkëmbime nga shteti i Greqisë;
- 1 shkëmbim nga shteti i Rumanisë;
- 4 shkëmbime nga shteti i Gjermanisë;

-1 shkëmbim nga shteti i Holandës.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe ka pasur rreth 82 shkresa nga shkëmbimi i informacionit me shtetet e huaja dhe nga shkëmbimi i informacionit me administratat tatimore brenda vendit (DRT- të) ku rezulton se janë mbyllur rreth 20 EOIR që kanë qenë të hapura.

➤ **Një analizë për muajin Nëntor dhe Dhjetor 2020 si dy muaj me volumin më të madh të shkresave:**

Në muajin Nëntor 2020 kanë hyrë 227 shkresa. Nga këto 111 janë aplikime të reja për zbatim marrëveshje të shmangies së taksimit të dyfishtë, 18 janë aplikime për certifikata rezidente, 3 janë aplikime EOIR dhe 17 janë kërkesa për interpretime. Pjesa tjetër e shkresave janë plotësime dokumentacioni për çështjet që janë ende në proces.

Në muajin Dhjetor 2020 kanë hyrë 343 shkresa. Nga këto 205 janë aplikime të reja për zbatim marrëveshje të shmangies së taksimit të dyfishtë, 18 janë aplikime për certifikata rezidente dhe 16 janë kërkesa për interpretime. Pjesa tjetër e shkresave janë plotësime dokumentacioni për çështjet që janë ende në proces.

Gjithashtu për trajtimin e shkresave EOIR për një kërkesë të iniciuar nga Autoriteti i Huaj Tatimor nga Inspektori që trajton rastin dalin dy shkresa, një shkresë në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe për Autoritetin e Huaj Tatimor për konfirmimin e marrjes së kërkesës dhe një shkresë i dërgohet Gjendjes Civile ose DRT-ve përkatëse apo cdo institucioni tjetër për marrjen e informacionit që nevojitet të mblidhet për të plotësuar kërkesat e Autoritetit të Huaj Tatimor.

-Inspektorët e Sektorit të Taksave Direkte janë angazhuar në grupe pune dhe kanë bashkëpunuar me strukturat e tjera për realizimin e qëllimeve dhe objektivave të vendosur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

-Kërkesat për Interpretimet në lidhje me Tatimin mbi të Ardhurat dhe Tatim Fitimin.

Tatimpaguesit për sqarime apo zbatim korrekt të dispozitave të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshur kërkojnë sqarime/interpretime në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Sektori i Taksave Direkte nga momenti i krijimit dhe deri në 31.12.2020 ka dhënë interpretim për 61 shkresa.

Shkëmbimi Automatik i Llogarive Financiare- Hartimi i draft-ligjeve dhe akteve nënligjore për Shkëmbimin Automatik të Informacionit.

Përgjatë vitit 2020 DTL ka ofruar bashkëpunimin e saj në hartimin e kuadrit ligjor për Shkëmbimin Automatik të Informacionit mbi llogaritë financiare në kuadër të Standartit të Raportimit të Përbashkët (CRS-Common Reporting Standard). Gjithashtu DTL ka asistuar dhe trajtuar kërkesat e ardhura për interpretim të këtyre akteve ligjore nga institucionet financiare raportuese, si dhe ka marrë pjesë në të gjitha takimet informuese të zhvilluara me institucionet financiare.

Në kuadër të këtij projekti gjatë këtij viti janë miratuar aktet ligjore të mëposhtme:

1. Ligji Nr. 4/2020, “Për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarive Financiare”, ndryshuar me ligjin nr. 109/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 4/2020, “Për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarive Financiare”.
2. VKM nr. 613, datë 29.07.2020 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.4/2020 "Për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarive Financiare".

Gjatë periudhës Nëntor-Dhjetor 2020, Sektori i Taksave Direkte është angazhuar në procesin e mbledhjes së informacionit mbi llogaritë financiare të raportueshme nga institucionet financiare dhe pas testimeve të kryera dhe trajnimit nga pala italiane, me datë 24.12.2020 ka dërguar këtë informacion **drejt 72 juridiksioneve (shteteve) të tjera.**

V. KONTROLLI TATIMOR

Gjatë vitit 2020, Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT, bazuar në objektivat Strategjike të hartuara dhe miratuar në Planin Strategjik 2017-2020, punoi dhe realizoi detyrat e ngarkuara në funksion të rritjes së performancës së Administratës Tatimore për mbledhjen dhe realizimin e të ardhurave buxhetore si dhe ishte pjesë integrale e menaxhimit të situatës pandemike dhe paketave financiare për shkak të Covid-19.

Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT ka funksion kontrollin e performancës së realizimit të detyrave nga Drejtoritë e Kontrollit në DRT dhe ofrimi i asistencës së duhur profesionale dhe analiza e dhënave statistikore të situatës së kontrolleve.

Objektivi kryesor i Drejtorisë së Kontrollit në DPT është udhëheqja metodologjike e funksionimit të kontrollit tatimor dhe monitorimi i punës së drejtorive tatimore rajonale.

Realizimet e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, bazuar në Rregulloren e Brendshme të Administratës Tatimore, në kërkesat e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave në zbatim të tij, në zbatim të objektivave të Planit Strategjik 2017-2021, si dhe në ndjekje të rekomandimeve të FMN-së.

Detyrat funksionale të Drejtorisë së Kontrollit janë si më poshtë dhe janë realizuar në përputhje me objektivat e miratuar në planin operacional për vitin 2020:

- ✓ Kryen kontrole dhe bën verifikime në bazë të planit vjetor në drejtoritë rajonale për të verifikuar nëse funksionet e kontrollit nga zyra dhe kontrollit në vend në këto drejtori kryhen në përputhje me procedurat e përcaktuara në Legjislacionin fiskal dhe që janë pjesë e Manualeve të Kontrollit.
- ✓ Raporton gjetjet që kanë dalë gjatë kontrolleve në lidhje me metodologjinë e kontrollit tek tatimpaguesit, mospërbushjet apo shkeljet ligjore, ose shërbimet e ofruara për tatimpaguesin, së bashku me rekomandimet për ndryshime të mëtejshme, duke propozuar edhe masa në rastet e shkeljeve administrative e ligjore. Dhe duke analizuar problematikat e konstatuara dhe mangësitë e inspektoreve të kontrollit ai rekomandon programet e trajnimit, për rritjen e aftësive të inspektorëve.
- ✓ Monitoron arritjet e drejtorive tatimore rajonale kundrejt planeve të dërguara për zbatim nga DPT, investigon ndryshimet nga plani i kontrollit, bën komente për çdo shmangie të dukshme në masat e marra në kontroll nga ato të planifikuara dhe merr masa për të korrigjuar këto shmangie, kur është e nevojshme. Gjithashtu, ofron këshillim dhe udhëzim të specializuar për një kontroll eficient dhe efektiv të tatimpaguesit.

1. Përzgjedhja për Kontroll

Në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 80, Kontrolli Tatimor, është hartuar dhe Manuali i Kontrollit Tatimor, sipas të cilit përcaktohet dhe përzgjedhja e tatimpaguesve për kontroll dhe plani mujor i tyre.

Përzgjedhja e tatimpaguesve për kontroll hartohet nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut pasi ka bërë seleksionimin e tatimpaguesve të cilët rezultojnë me risk sipas modulit të Riskut.

2. Objektivat për vitin 2020

Objektiva të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor janë pjesë e tre objektivave kryesore të Planit Strategjik 2017-2021. Bazuar në objektivat strategjike përkatësisht për Drejtorinë e Kontrollit objektivat dhe aktivitete konkrete të ndërmarra për vitin 2020 janë si më poshtë:

Objektivi 1: *Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare.*

Nënobjektivi 1.3: Zbatimi i metodologjive dhe praktikave njëhsuese

Aktiviteti: Garanton praninë e sistemeve të qarta dhe të rregulluara për operacionet e kontrollit tatimor të tatimpaguesve, që ato të kuptohen e të pranohen si të drejta e të arsyeshme si edhe të zbatohen dhe të ndiqen vazhdimisht nga DRT;

- ✓ Përgatitje e udhëzimeve apo rregulloreve që do ndihmojnë në procesin e kontrollit.
- ✓ Analizimi i propozimeve nga DRT-të në lidhje me 30% të planit për kontrollet tatimore.

Objektivi 2: *Implementimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor*

Nënobjektivi 2.1: Zbatimi i strategjisë së përmbushjes së menaxhimit të riskut.

Aktiviteti: Miraton planet mujore të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor me detyra të të gjithë sektorëve përbërës të saj, dhe planet e punës për secilin sektor.

- ✓ Analizimi i të dhënave dhe raporteve të kontrollit në përputhje me legjislacionin dhe nxjerrje e rekomandimeve.
- ✓ Rishikimi i Rregullores për përzgjedhjen e tatimpaguesve për kontroll, mënyrën e kontrollit dhe integrimin me planet sektoriale

Nënobjektivi 2.2: Përmirësimi i mëtejshëm i kontrollit tatimor dhe gjurmimi i mashtrimeve tatimore.

Aktiviteti 1: Harton dhe Miraton planet operationale të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor me detyra të të gjithë sektorëve përbërës të saj, dhe planet e kontrollit për cdo drejtori rajonale.

- ✓ Miratimi i kërkesave për kontroll nga drejtoritë rajonale.
- ✓ Harton dhe miraton planet e punës dhe planet operationale për sektorët përbërës.

Aktiviteti 2: Merr masa që rekomandimet dhe kërkesat e auditit të Ministrisë së Financës, Kontrollit të Lartë të Shtetit, rekomandimeve të FMN dhe institucioneve të tjera shtetërore, të ndiqen dhe zbatohen në lidhje me kontrollin e tatimpaguesve;

- ✓ Hartimi i një propozimi ligjor për përdorimin e autofaturimit, ku marrësi i shërbimit të ndërtimit do të jetë përgjegjës për pagesën e TVSH së nenkontraktoreve.
- ✓ Përgatitja dhe finalizimi i skenareve të mundshme për përdorimin e metodave alternative.
- ✓ Përditësimi i Manualit të Kontrollit Tatimor, me një kapitull të veçantë për metodat indirekte.

Aktiviteti 3: Verifikimi i Drejtorive Rajonale mbi problematikat e kontrollit tatimor, verifikimit në terren, vlerësimit dhe analizës së riskut; Realizon kontrole në Drejtoritë Rajonale.

- ✓ Programi i kontrollit në DRT, lidhur me funksionimin e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor.
- ✓ Monitorimi i përmbushjes së kontrollit tatimor në tatimpaguesit e përzgjedhur për kontroll, për periudhat e pakontrolluara dhe detyrat e lëna për zbatim nga kontrollet e mëparshme.
- ✓ Kontrolli i Performancës së punës së Drejtorive të Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë, Vlorë, Kukës, Dibër, Shkodër, Berat, Durrës në DRT, përdorimi i kriterëve të duhura për vlerësim, me qëllim që të prodhojë efekte në plotësimin e detyrave të ngarkuara.

Objektivi 3: *Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore*

Nënobjektivi 3.2. *Zhvillimi i kapaciteteve dhe motivimi i punonjësve*

Aktiviteti: Zbaton dhe rekomandon programet e trajnimit për drejtuesit dhe inspektorët e kontrollit tatimor.

- ✓ Evidentimi i nevojave për DRT dhe DPT nëpërmjet hartimit të një pyetëso, ku të përcaktohen fushat e trajnimit, sektorët, etj

Nënobjektivi 3.3. *Mbajtja e proceseve optimale dhe struktura e Administratës Tatimore.*

Aktiviteti: Përmirësimi i cilësisë së kontrolleve. Përditësimi i procedurave të kontrollit për të siguruar kryerjen në kohë dhe në mënyrë standarte të tyre.

- ✓ Analizimi i të dhënave dhe miratimi i tatimpaguesve për kontroll mujor.

- ✓ Analiza e gjetjeve dhe rezultateve të raporteve të kontrollit tatimor dhe nxjerrje e rekomandimeve për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së kontrollit. Përmirësimi i cilësisë së kontrolleve dhe përditësimi i procedurave të kontrollit për të siguruar kryerjen në kohë dhe në mënyrë standarde të tyre;
- ✓ Përdorimi i një qasjeje sistematike për të zgjedhur dhe përshtatur strukturat apo proceset nëpërmjet analizës së efikasitetit dhe efektivitetit të ndryshimeve organizative, duke përfshirë analizat kosto-përfitim dhe matjen e efektivitetit nga zbatimi i këtyre ndryshimeve;

3. Aktivitete të realizuara për vitin 2020 dhe problematikat

- Kushtëzuar nga situata e krijuar nga Covid 19 kontrollet tatimore u pezulluan përgjatë një periudhe disa mujore.
- Në mënyrë të vazhdueshme u është përcjellë DRT-ve çdo udhëzim dhe vendim mbi menaxhimin e kontrolleve tatimore.
- Drejtoria e Kontrollit përcakton dhe miraton prioritet dhe objektivate për çdo sektor planet mujore të punës.
- Drejtoria e Kontrollit miraton çdo muaj planet e kontrollit sipas propozimeve nga DRT të 30% të subjekteve për kontroll.
- Bazuar në rekomandimet e KLSH është hartuar dhe Miratuar Rregullorja nr. 25441 prot. datë 31.12.2020 për kontrolli në DRT nga inspektorët e Kontrollit në DPT.
- Për shkak të situatës së krijuar nga Covid 19 kontrollet në DRT u pezulluan nga situata pandemike.
- Është në proces me autorizimi nr. prot. 19297, datë 06.10.2020 kontrolli tematik në DRT Berat dhe Gjirokastrë, nga Sektori i Cilësisë dhe Standartizimit si dhe janë kryer kontrolle Verifikuese në kuadër të Planit Operacional.
- Propozimet për trajnime sipas moduleve të Kontrollit për drejtorin, përgjegjësit e sektorëve dhe inspektorët e Drejtorisë së Kontrollit janë përfshirë në planin vjetor të trajnimeve për Administratën Tatimore.
- Inspektorët e kontrollit gjatë viti 2020 kanë ndjekur trajnime online për Fiskalizimin, Shkëmbimin Automatik etj.
- Automatizimi i raportit të kontrollit është përfunduar nga Drejtoria e Kontrollit.
- Është hartuar rregullore për dorëzimin e pasqyrat financiare.
- Angazhimi në grupet e punës për ndihmat financiare, procesin e rindërtimit, amnistia fiskale etj.

- Hartimi i planit dhe monitorimi i realizimit të vizitave fiskale për realizimin e të ardhurave për vitin 2020 sipas Planit Operacional Korrik-Dhjetor 2020. Sektorët e Turizmit, Tregtisë dhe Ndertimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Manaxhimit të Riskut janë përfshira në Planin Operacional Korrik-Dhjetor 2020.

VI.MENAXHIMI I RISKUT

Drejtoria e Menaxhimit të Riskut ne organigramen e DPT është në varësi të Drejtorisë së Hartimit të Programeve dhe drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së DMR edhe organizuar në 2 sektore.

- Sektori i Analizës së Riskut -me 1 Përgjegjes dhe 10 Specialiste (1+4 pozicione vakante)
- Sektori i Hartimit të Strategjive për Trajtimin e Risqeve -me 1 Përgjegjes dhe 6 Specialistë (1 pozicion vakant)

Objekti parësor i modelit të riskut që ushtron veprimtarinë DMR është identifikimi mbi bazën e kritereve të miratuara dhe zhvilluara paraprakisht i tatimpaguesve që përbëjnë risk potencial lidhur me përmbushjen, veprimtaria tregtare e të cilëve do të verifikohet dhe trajtohet nga ana e Administratës Tatimore në harmoni me procedurat ligjore në fuqi.

1. Objektivat e Drejtorisë për vitin 2020

Objekti Strategjik i DMR është përmirësimi i analizës dhe vlerësimit të risqeve të rëndësishme të mosrespektimit të legjislacionit tatimor që ka një ndikim në uljen e hendekut të mospërmbushjes. Ky objektiv bazohet në këto shtylla të rëndësishme:

- Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve sektoriale të përmbushjes dhe reduktimi i nivelit të riskut.
- Zgjerimi i kapaciteteve për të ekzaminuar të dhënat nga burime të ndryshme gjatë analizës së riskut të përmbushjes së tatimeve.
- Përdorimi i burimeve të informacionit nga palë të treta dhe sigurimi që çdo informacion të jetë i integruar në modelin e kontrollit duke u bërë një faktor për vlerësimin e riskut.
- Hartimi i analizave cilësore që fokusohet në target risqe specifike.
- Monitorimi i rregullt i niveleve të përmbushjes.
- Forcimi i kapaciteteve dhe bashkëpunimi i pandërprerë me bizneset duke synuar marrjen e një baze të plotë të dhënash.

Tregues kryesore te performances jane:

- Madhësia e hendekut tatimor sipas llojeve të risqeve
- Zvogëlimi i riskut të sjelljes së tatimpaguesve, pas trajtimit – reduktimi i numrit të tatimpaguesve me risk.

- Zvogëlimi i riskut të sjelljes së tatimpaguesve, pas trajtimit – reduktimi i hendekut të permbushjes.
- Vlera dhe numri i deklaratave të korrigjuara nga tatimpaguesit, si rezultat i njoftimeve të dërguara apo takimeve të mbajtura me ta.

Lidhja e objektivave me rekomandimet e TADAT.

Objektivat e DMR janë në përputhje me vleresimin e TADAT Gusht 2016, Kapitulli III

Vlerësimi i performancës së të ardhurave tatimore, POA 2 - POA 6

Aktivitet e programuara dhe realizuar gjatë vitit 2020 në funksion të realizimit të objektivave.

2. Planet sektoriale të realizuara gjatë vitit 2020

2.1 Planet Sektoriale

Gjatë vitit 2020 DMR nën asistencën e ekspertit të FMN analizoi përfundimin e planit Sektorial të Bar- Restorante dhe hodhi bazat e hartimit të Planit Sektorial të Ndertimit.

Gjatë periudhës Janar-Mars nga DMR u realizua Analiza e Riskut në Sektorin e Ndërtimit, por nuk u arrit të realizohej procesi i hartimit të strategjisë për trajtimin e riskut në këtë sektor për arsye të pandemisë COVID-19.

2.2 Plani sektorial në Informalitetin në tregun e punës

Gjatë vitit 2020 u vazhdua me implementimin e Planit Operacional për Informalitetin në tregun e punës. Ecuria e këtij plani ishte përherë në trend rrites gjë që u vlerësua edhe nga ekspertet e Bankës Botërore të cilët u përfshinë në përmirësimin dhe avancimin e mëtejshëm të këtij plani. DMR nën asistencën e BB evidentuan profesione të reja me riskun e nëndeklarimit të pagës për të cilën u zgjodh trajtimi nëpërmjet letrave të personalizuar të hartuara nën kujdesin dhe asistencën e eksperteve.

U analizua Informaliteti në tregun e punës për të 4-t komponentët e tij si:

1. Mosregjistrimi i punonjësve
2. Mosdeklarimi i pagave reale
3. Mosdeklarimi i saktë i kohës së punës
4. Mosdeklarimi i saktë i kategorisë së profesionit dhe kategorisë së sigurime
 - Tatimpagues të cilët bëjnë deklaram sigurimesh shoqërore me vlerë 0-1 leke
 - Tatimpaguesve me lëvizje të shpeshta të punonjësve;

2.2.1 Nisma e ndërmarrë në bashkepunim me Bankën Botërore në lidhje me nëndeklarimin e pagave.

Nga analiza e pagave të deklaruara u vlerësuan si paga me nëndeklarim të gjitha pagat për

profesionet inxhinier, ekonomist, farmacist, administrator, kuzhinier, laborant, bukëpjekes etj deri në vlerën 30 000 lekë. Në total u vendos që të dërgohej leter e personalizuar për 3.619 tatimpagues dhe 3.714 punonjës. U vendos që të dërgohen dy lloje letrash, si për punëdhënesin edhe për punëmarrësin, njëra me një tekst me përmbajtje “STRONG” dhe tjetra me tekst me përmbajtje “SOFT”. Në letrat për punëmarrësit ju kërkohet që të deklaronin nivelin real të pagës për punonjesit e tyre dhe nga ana tjetër punëmarresve ju kërkohet që të kërkonin deklarinimin real të pagës së tyre nga punëdhënësi.

2.2.2 Nisma në lidhje me deklarinimin e pagës bruto 1 lek dhe lëvizjet e shpeshta të punonjësve

U identifikuan 3.532 tatimpagues që deklarojnë punonjes me page bruto 1 lek dhe 1.044 tatimpagues që bëjnë shpesh lëvizje të punonjesve të tyre, lëvizje punonjësi më shumë se 1 herë në muaj. Për këto tatimpagues u dërguan letra të personalizuar ku ju bëhej me dije se Administrata Tatimore ka konstatuar që deklarohen punonjës me 1 lek apo kanë lëvizje të shpeshta të punonjesve brenda të njëjtes periudhe tatimore mujore dhe ju kërkohet që të deklaronin nivelin real të pages për punonjesit e tyre si dhe ju bë me dije se do të vazhdojnë të jenë objekt i monitorimit të vazhdueshëm.

2.2.3 Nisma e ndërmarre në lidhje me nendeklarimin e pagave (26’000 lek), plani operacional Korrik-Dhjetor 2020.

Nga analiza e pagave të deklaruara në muajin Qershor 2020 u vlerësuan si paga me nendeklarim të gjitha pagat për profesionet inxhinier, ekonomist, farmacist, mekanik, murator, saldator, teknik etj në vlerën 26’000 leke (në nivelin e pages minimale). Në total u identifikuan 5.359 tatimpagues dhe 10.785 punonjes, por 89 tatimpagues të DTM-se u kthyen mbrapsht nga kjo e fundit pasi në Qershor ishin kontaktuar edhe një herë nga DTM-ja për nivelin e ulët të fondit të pagave. U nisën 5.270 letra për punëdhënesit dhe 10.170 letra për punëmarresit në të cilat ju kërkohet që të deklaronin nivelin real të pages për punonjesit e tyre dhe nga ana tjetër punëmarresve ju kërkohet që të kërkonin deklarinimin real të pages së tyre nga punëdhënësi.

2.2.4 Nisma e marrë për DRT Tiranë dhe DTM si faze pilot është bërë krahasimi i nivelit të pagave ndërmjet periudhave 12/2019 dhe 06/2020 për të evidentuar dhe kontaktuar tatimpaguesit me ulje të pagave për punonjës me shumë se 5.000 lekë/muaj. Ndryshime në sistemin “C@ts” për të mos lejuar përdorimin e kategorise së punonjesve që fillon punë për herë të parë.

3. Përmirësimi i Modullit të Riskut

Rregullat e modullit të riskut janë në proces të vazhdueshëm përmirësimi pasi ndikohen drejtpërdrejtë nga ndryshimet në paketat fiskale, nga sjellja e tatimpaguesve si dhe nga dinamika e mjedisit ekonomik. Në kuadër të përmirësimit të funksionalitetit të rregullave, pas testimeve të vazhdueshme

për evidentimin e problematikave të tyre, DMR ka bërë ndryshimet e nevojshme në logjikë si dhe në përditësimin e dokumentit në ëord.

Ne bashkepunim me specialist në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për të siguruar mbarëvajtjen e modelit, zhvillimet e reja dhe përditësimin janë analizuar të gjitha të dhënat nga Modeli i Riskut si dhe informacione të tjera dhe identifikon sjellje dhe trende të reja të sjelljes së tatimpaguesve.

Gjate periudhes Janar – Dhjetor janë hapur 11 Jira në sistem për të trajtuar problematikat që janë evidentuar dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme.

U testuan rregullat e Modulit të Riskut si me poshte:

- TCSAL - Mat devijim e fondit të shpenzimit për paga krahasuar me mesataren e sektorit ku operon tatimpaguesi.
- TCSALA- Mat devijim e fondit të shpenzimit për paga si dhe “nëndeklarimin për profesion të caktuar” nga mesatarja e sektorit ku operon tatimpaguesi.
- TCSALB -Mosdeklarim i pagës reale të punonjësve krahasuar me mesataren e profesionit.
- VATREF1S - Mosdeklarim i saktë i shitjeve. Kryqëzim i numrave serial të faturave.
- VATREF1B - Mosdeklarim i saktë i blerjeve. Kryqëzim i numrave serial të faturave.
- VATREF 3 - Rritje e kredise se TVSH-se duke nendeklaruar shitjet.
- VATREF 2 - Rritje e kredise se TVSH-se duke rritur në menyre fiktive blerjet.
- VATREF 4 - Importues në Doganë por pasive në Tatime.
- VAT EXP - Mosdeklarimi i sakte i Eksporteve.
- VAT IMP - Mosdeklarimi i sakte i Importeve.
- ËHDP - Ulje e vazhdueshme në deklaratën e TB.

U kryen dhe u aprovuan Kërkesa për Ndryshim si më poshtë:

- "Kërkesa për Ndryshim" nr.39 për rregullin e riskut TCSALA SLA2-329.
- "Kërkesa për Ndryshim" nr.40 për rregullin e riskut TCSALB SLA2-345.
- "Kërkesa për Ndryshim" nr.53 për rregullin e riskut VAT EXP SLA2-387.
- "Kërkesa për Ndryshim" nr.44 për rregullin e riskut VATREF1B SLA2-327.
- "Kërkesa për Ndryshim" nr.43 për rregullin e riskut VATREF1S SLA2-326.

3.1 Marrëveshjet e Bashkëpunimit Ndër-institucional

Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe Drejtoria e Procesve të Bisnesit ka evidentuar regjistrat elektronik të palëve të treta që janë publikuara në GOVNet dhe në bashkëpunim me AKSHI-n po evidenton mundësinë për shfrytëzimin e të dhënave duke i përfshirë në Data ëarehouse e sistemit të fiskalizimit. Në kuadër të bashkëpunimit me palet e treta për shkëmbimin e të dhënave, DMR ka firmosur memorandumit të bashkëpunimit me OSHEE (Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike), Bashkinë e Tiranës dhe është në proces firmosje me Shoqatën e Eksperteve Kontabel (IEKA) dhe UKT.

3.2 Analizimi i riskut të tatimpaguesve që bëjnë Kërkesë për Rimbursim

Gjatë Vitit 2020 kanë ardhur 155 kërkesa për rimbursim të cilat janë për 691 tatimpagues të ndryshëm. Bazuar në analizat 3 mujore të bazuara në ekzekutimet e Modulit të Riskut 151 tatimpagues janë propozuar për kontroll. Më poshtë tabela e specifikuar sipas muajve të vitit 2020:

Përmbledhje e Kërkesave për Rimbursim TVSh-je			
Muaji	Numri i kërkesave të ardhura	Numri i tatimpaguesve që kërkojnë Rimbursim TVSH-je	Numri i tatimpaguesve që propozohen për kontroll bazuar në Analizën e Riskut
JANAR	4	16	10
SHKURT	14	50	26
MARS	14	60	15
PRILL	21	83	26
MAJ	15	67	13
QERSHOR	17	82	6
KORRIK	15	65	10
GUSHT	7	23	6
SHTATOR	16	71	15
TETOR	12	54	8
NENTOR	10	64	9
DHJETOR	10	56	7
TOTALI	155	691	151

3.3 Ndryshimi i përgjegjesive tatimore bazuar në të dhënat e paisjeve fiskale dhe deklaratat mujore të TVSH-së;

Gjate vitit 2020 nga ana e DMR ne menyre periodike jane analizuar te dhenat e paisjeve fiskale, deklaratat mujore te TVSH-se per te pare sjelljen e tatimpaguesve ne raport me përgjegjesine tatimore qe ato perfaqesojne dhe jane derguar neper DRT ne menyre periodike.

Nga analizat e realizuar rezultojne:

- 4.472 tatimpagues te evidentuar per ndryshim përgjegjesie tatimore ne BM bazuar ne deklaratat mujore te TVSH-se.
- 216 tatimpagues te evidentuar per ndryshim përgjegjesie tatimore qe jane derguar prane DRT-ve per verifikim per ndryshim përgjegjesine tatimore ne BM dhe BV ME TVSH bazuar ne te dhenat mujore te paisjeve fiskale.

Me poshte tabela permbledhese sipas muajve te vitit 2020.

Muaji	Nr.TP qe jane evidentuar per ndryshim nga Deklaratat e TVSh-se	Nr.TP qe jane evidentuar per ndryshim përgjegjesie nga te dhenat e paisjeve fiskale
Janar		22
Shkurt	11	41
Mars		
Prill		47
Maj		
Qershor	3.480	106
Korrik		
Gusht		
Shtator		
Tetor	529	
Nentor	227	
Dhjetor	225	
Totali	4.472	216

Evidentimi i TP që rezultojnë me mospërputhje të xhiros së deklaruar në të dhënat e paisjeve fiskale me Xhiron në deklaratat mujore të TVSH-së.

Gjate periudhes Shtator – Dhjetor 2020 jane evidentuar tatimpaguesit te cilet kane rezultuar me xhiro me kase me te madhe se ajo e deklaruar ne deklaratat e TVSH-se dhe u jane derguar DRT-ve perkatese.

4. Analiza periodike për tatime të veçanta dhe për sektore të caktuar;

Nismat kryesore ku DMR u angazhua gjeresisht ishin ne hartimin e “Planin Strategjik 2020-2021” miratuar ne Komitetin e Reformave me Vendimin nr.16292 date 19.08.2020 dhe “Planin Operacional Korrik – Dhjetor 2020 miratuar me vendimin e Komitetit Operacional nr.12444 date 03.07.2020 Keto plane jane mbështetur në parimet dhe objektiva të qarta me bazë inteligjencën (Riskun).

Plani operacional Korrik-Dhjetor 2020 perfshinte planin e turizmit, te zhvilluar gjate muajve te veres dhe fokusin e Administrates Tatimore ne sektore si Tregtia dhe Ndertimi si sektore me pak te prekur nga gjendja e pandemise dhe si sektore me ndikim ne realizimin e te ardhurave.

Gjate gjithë periudhes Qershor –Dhjetor 2020 DMR ka evidentuar fenomene me risk dhe ka perzgjedhur menyren e trajtimit ne te gjitha format nga dergimi i njoftimeve me “Pop up”, Call center, letrave te personalizuar dhe vizitave fiskale e monitorimeve ne terren.

Gjate vitit 2020 per arsye te pandemise COVID 19 per peridhen Mars-Qershor 2020 pati nje nderprerje te kontrolleve ndersa ne “ Planin Operacional Korrik – Dhjetor 2020” te miratuar nga Komiteti Operacional me vendimin nr.12444 date 03.07.2020.

Kriteret e riskut të aplikuara në perzgjedhjen e TP per trajtim ishin si me poshte:

- Tatimpagues të cilët gjatë periudhës Janar-Maj 2020 rezultojnë me rritje të qarkullimit por me rënie të TVSH së detyrueshme për t’u paguar.
- Tatimpaguesit qe janë kontribuesit kryesore të të ardhurave duke përjashtuar bankat, ente publike te cilët bazuar në Modulin e Riskut kanë thyer kriteret risku por që nuk janë kontrolluar pas Qershorit 2019. Ndaj tyre vleresohet që bazuar në numrin e kriterëve të thyera të jetë edhe reagimi administratës tatimore.
- Tatimpagues te cilët ushtrojne aktivitet në Sektorin e Tregtisë te cilët bazuar në të dhënat e deklarimeve dhe pagesave të TVSH rezulton me nje gjendje kreditore te mbartur me te madhe se 1.000.000 leke.

Gjithashtu jane marre dhe Iniciativa te tjera qe nxisin permbushjen vullnetare, nder te cilat permendim:

4.1 Krahasimi xhiro me kase / deklaratë TF ose TFTH për vitin 2019

Jane evidentuar TP qe rezultojne me xhiro me kase per vitin 2019 por nuk kane plotesuar deklaraten vjetore te TF dhe TFTH dhe TP qe rezultojne me xhiro me kase me te madhe se 25.000 leke ne krahasim me deklaraten vjetore te TF ose TFTH per vitin 2019.

4.2 Evidentimi i TP me raportin blerje shitje më të madhe se 25% (përfshijtur blerjet per investim)

Bazuar ne te dhenat e deklaratave te TVSH-se per mujore jane analizuar te dhenat e tatimpaguesve te cilet rezultojne me 25% blerje me shume se pasi jane hequr blerjet dhe importet per investime. Keto TP jane kontaktuar nepermjet DRT-ve dhe ne rastet e mos permiresimit te treguesve jane derguar per monitorim nga DVKT.

4.3 Evidentimi i TP që nuk deklarojnë faturat e energjisë elektrike

Jane derguar letra te personalizuar tatimpaguesve BV ME TVSH te cilet gjate vitit 2019 nuk kane deklaruar fatura blerje te energjise elektrike nga OSHEE ne librat e blerjes.

4.4 Verifikimi i hartuesve të bilanceve 19A

Jane evidentuar Kontabiliste/Eksperte te cilet kane dhene sherbime lidhur me Bilancet 19A. TP u eshte derguar Leter nga DRT-te perkatese. Eshte gjykuar e nevojshme te analizohen transaksionet e kryera mes ketyre nipteve nga D.Hetimit ne kuader te evidentimit te dy risqeve baze te cilat kane rezultuar gjate Testimeve qe DMR ka kryer per disa TP:

1. Risku i mos-deklarimit te faturave nga njera pale.
2. Risku i shkembimit te faturave mes tyre me qellim uljen e detyrimeve tatimore (vecanerisht TVSH).

4.5 Evidentimi i TP me fatura blerje me vlere te larte ne fund te muajit Tetor, Nentor dhe Dhjetor 2020.

4.6 Evidentimi i TP me renie te vazhdueshme te Qarkullimit.

4.7 Mesazh “Pop Up” – TP ne sektorin e Hidrokarbureve qe vendosin NIPT jo te sakte.

TP me fatura shitje ku NIPT-i i bleresit nuk eshte i sakte iu dergua Mesazh Pop Up i cili u

shfaq per 7 dite me vijim.

4.8 Google FORM:

U krahasua numri i punonjesve te deklaruar ne Google Form me numrin e punonjesve ne deklaratat e Listpagesave Korrik 2020. NIPT-et te cilet kishin deklaruar me shume punonjes ne Google Form sesa ne Listpagese iu derguan D.V.K.T per te kryer verifikimet perkatese.

4.9 Mos-deklarimi i Faturës së Energjisë Elektrike

TP me vlere konsumi vjetor mbi 200.000 leke jane njoftuar nga AT nepermjet Letrave qe te bejne korrigjimet perkatese ne Librat e Blerjeve. TP me te dhena tel te sakta qe nuk kishin reaguuar u derguan ne Qendren e Thirrjeve qe te kontaktohen dhe te merren arsyet se mos-deklarimit te fatures se energjise elektike.

4.10 Listat me subjekte të cilat kanë Shitje me shkalle tatimore TVSH =6%, 10% TF=5%

U evidentuan Listat me subjekte te cilat kane Shitje me shkalle tatimore 6%, 10%, 5% te cilat iu derguan DRT-ve per te kryer verifikimet perkatese.

4.11 Njoftim i TP per te dorezuar Deklaratat Tatimore nepermjet Call Center- DSH

Evidentimi i TP Mos-deklarues te Listepagesave 3 Muajt e fundit.

Evidentimi i TP Mos-deklarues te TVSH-se 3 Muajt e fundit.

Evidentimi i TP me Vleresim Automatik per TF 19A.

4.12 Evidentimi i TP me Autongarkesë në Blerje më të madhe se Autongarkesa në Shitje Janar-Shtator

U evidentua Lista e tatimpaguesve sipas DRT-ve, qe rezultojne me Diference (mbi 10,000 leke) ne Autongarkese bazuar në të dhënat e deklaratave te TVSH-se per periudhen Janar – Shtator 2020. Derguar DRT-ve qe pasi të bëjne verifikimet perkatese te marrin masa për korrigjimin e deklaratave.

5. Te tjera aktivitete te realizuara nga DMR gjate vitit 2020.

Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në DPT është përgjegjëse për menaxhimin e përzgjedhjes automatike të tatimpaguesve për kontroll, bazuar në kriteret e miratuara të riskut. Hartimi i planeve mujore te kontrollit, planifikim i rasteve per rimbursim referuar shkresave te DRTVSH dhe hedhja e

evidencave te kontrollit ne nje plan-fakt te perbashket per 14 DRT. Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut përzgjedh 70% të tatimpaguesve për kontroll tatimor te plote në vend sipas të dhënave të regjistrit elektronik të riskut, dhe do të miratojë 100% të kontrolleve që do të zhvillohen në shkallë vendi.

Jane kryer ekzekutimet e modulit të riskut për projektet sektoriale, për rimbursimin e TVSH-së apo nevoja të tjera analizash.

Gjate vitit 2020 jane kryer:

- 4 ekzekutime te Modulit te Riskut per Rimbursimin e TVSH-se.
- 3 ekzekutime te Modulit te Riskut per Listat e Hetimit sipas manualit.
- 2 ekzekutime te Modulit te Riskut per Planet e Kontrollit.

5.1 Aktivitete jo te parashikuara ne planifikimin fillestar, por te realizuara gjate vitit 2020

Situata e pandemise ne vend solli nevojën e perfshirjes se stafit te DMR-se ne grupe pune si me poshte:

- Paketa nr.1, “VKM nr.254 datë 27.03.2020 Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasoje e covid-19.
- Paketa nr.2 “VKM nr.305 datë 16.04.2020”, Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasoje e covid-19 të ndryshuar.
- Paketa nr.3 sipas VKM nr.651, datë 13.08.2020 Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare, si pasoje e covid-19, për të punësuarit apo ish-të punësuarit në subjektet e transportit publik, qytetas dhe ndërqytetas
- Paketa nr.4 në bazë të VKM Nr.856 datë 04.11.2020 “Për ndihmën financiare të disa prej kategorive kryesore të ndërmarrjeve, të cilat zbatojnë protokollet e sigurisë, në kuadër të parandalimit e të kontrollit të pandemisë Covid – 19”
- Në zbatim të Ligjit Nr. 4/2020 “Për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarive Financiare”.
- “Projekti i bashkëpunimit me Agjensinë Tatimore Suedeze (STA)”.

- Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr. 51, datë 17.07.2020 “Monitorimi dhe ndjekja e zbatimit në përgjithësi të Planit Operacional Korrik- Dhjetor 2020”.
- Projekti i Fiskalizimit.
- Urdhër e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr. 40, datë 19.06.2020 “Për rimbursimin e gjobave të vendosura shtetasve shqiptarë jashtë Republikës së Shqipërisë, si pasojë e situatës së shkaktuar nga COVID-19”.
- Urdhër e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr. 23556 Prot., datë 07.12.2020 “Komisionit të Inventarizimit të vlerave materiale në ngarkim të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe magazinave të saj për vitin 2020”.
- Urdhër e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve Nr. 85 date 24.11.2020 dhe ne baze te VKM-se Nr. 909, date 18.11.2020 "Dhenien e ndihmes financiare per punonjesit dhe ish-punonjesit e rafinerise se naftes, Ballesh".
- Urdhër inventarizimi “Nxjerje jashte perdorimit te materialeve gjendje ne magazine DPT, Urdheri i punes me dt 17/02/2020, me nr prot.2142.
- Rindertimi - VKM 143, dt 13/02/2020 me Urdhrr Pune Nr. 37, datë 22.05.2020 Për procedurat për lëshimin e autorizimit, për subjektet e rindërtimit dhe për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar të furnizimit të mallrave e shërbimeve, për qëllime të procesit të rindërtimit.

VII. MBLEDHJA ME FORCË

Në zbatim të detyrave operacionale, menaxhimi i detyrimeve të papaguara në afat gjatë vitit 2020 është mbështetur në objektivat strategjikë dhe është përqëndruar në garantimin e mbledhjes së detyrimeve të prapambetura, duke siguruar respektimin e të drejtave të tatimpaguesve, uljen e ekspozimit ndaj rreziqeve që lidhen me mbledhjen e detyrimeve të prapambetura dhe në të njëjtën kohë, evidentimit sa më real të gjendjes së detyrimeve tatimor, bazuar në të dhënat e dërguara nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, sipas evidencave që raportohen çdo muaj nga ana e tyre.

Ecuria dhe gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara në afat deri në 31 Dhjetor 2020 paraqitet si më poshtë:

Gjendja e detyrimeve të papaguara në afat në datë 01.01.2020	117 mld lek
--	-------------

Gjendja në datë 31 Dhjetor 2020	122.5 mld lek
---------------------------------	---------------

Në detyrimet prej 122.5 mld lekë, i cili ndiqet deri më 31 Dhjetor 2020, është e përfshirë edhe vlera prej 13.7 mld lekë, e cila është në proces gjyqësor, ku deri në fund të Dhjetor 2020 zë 11% të stokut të detyrimeve të papaguara.

Gjatë periudhës së marrë në analizë, detyrimet tatimore kanë pësuar një rritje neto 5.4 mld lek në krahasim me fillimin e vitit ose thënë ndryshe është rritur stoku i detyrimeve me 5%.


Detyrimet e pakesuar gjatë vitit 2020 janë 19.8 mld lekë. Në detyrimet e pakesuar përfshihen arketimet dhe sistemimet e ndodhura gjatë periudhës.

Detyrimet tatimore të papaguara në afat deri më datën 31 Dhjetor 2020 të specifikuar sipas zërave përbërës paraqiten si më poshtë:

- Principali i Detyrimeve me 60 %
- Penalitete 35%
- Kamatvonesa 5%


Nga të dhënat e mësipërme rezulton se principali i detyrimeve tatimore të akumuluar përbën rreth 60% të shumës totale të detyrimeve tatimor, ndërkohë që pjesa tjetër e këtyre detyrimeve 41 % e mbetur përbëhet nga penalitetet dhe kamatvonesat.

Grafiku 1 Detyrimet sipas Llojit të Tatimit



Në stokun e detyrimeve të papaguara në afat të ndarë sipas llojit të tatimit, TVSH zë peshën më të madhe në stokun me borxhit me 34% në vlerë 41,9 mld leke, e ndjekur nga Tatim Fitimi me 27% në vlerë 33,4 mld leke, zëri Të Tjera me 24% në vlerë 28,1 mld leke, Sigurimet Shoqërore & Shëndetësore me 14% në vlerë 17 mld leke dhe TAP me 2% në vlerë 2,1 mld leke.

Grafiku 2. Detyrimet sipas Llojit të Tatimit 2019 vs 2020



Krahasuar me fundin e vitit 2019, gjatë këtij viti TAP ka qëndruar në të njëjtin nivel, ndërkohë që TVSH është rritur me 1.51 mld lekë, Tatim Fitimi me 1.75 mld lekë, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore me 1.85 mld lekë dhe zëri Të Tjera me 0.26 mld lekë.

Tabela 1. Moshë e detyrimeve të papaguara në afat

MOSHA E BORXHIT DERI NË 31.12.2020						
Periudha	borxhi deri në 3 muaj	borxhi nga 3 - 6 muaj	borxhi nga 6-12 muaj	borxhi nga 1-2 vjet	borxhi nga 2-5 vjet	borxhi mbi 5 vjet
Detyrimet e papaguara në afat	4,652,467	5,744,053	12,385,214	16,419,808	54,081,761	29,185,106

Në total stokun e borxhit **122.5** mld lek, borxhi sipas vjetërsisë paraqitet si më sipër ku:

- *borxhi deri në 3 muaj* **4% ndaj totalit të stokut**
- *borxhi nga 3 - 6 muaj* **5% ndaj totalit të stokut**
- *borxhi nga 6-12 muaj* **10 % ndaj totalit të stokut**
- *borxhi nga 1-2 vjet* **13% ndaj totalit të stokut**

Borxhi me vjetërsi mbi 2 vjet **vlerë 83,3 mld Lek** është **68% ndaj totalit të stokut**,

Referuar moshës së detyrimeve të papaguara vihet re se detyrimi me i ri është arkëtuar duke përdorur analizën e profilit të riskut (detyrimet me i ri dhe vlera më e lartë) si dhe duke ndjekur vetëdeklarimet për çdo muaj nga Sektori i Analizës në Rajonet e Mbledhjes, me qëllim rritjen e performacës në arkëtimin e detyrimeve tatimore.

Grafiku 3. Detyrimet sipas statusit të tatimpaguesit



- *Subjektet Aktiv zënë 42% të numrit total të subjekteve debitor me një vlerë prej 39,8 mld lek ose 32% të masës totale të borxhit.*
- *Subjektet Pasiv zënë 58% të numrit total të subjekteve debitor me një vlerë prej 68,6 mld lek ose 68% të masës totale të borxhit.*

Gjate viti 2020 janë ndërmarrë një varg iniciativash për të forcuar funksionin e mbledhjes së detyrimeve të prapambetura tatimore me fokus forcimin e kuadrit ligjor, përmirësimin e proceseve të punës, lehtësimin e proceseve të komunikimit me tatimpaguesit me qëllim ndjekjen e menjëhershme

të detyrimit të ri, duke parandaluar kthimin e tij në detyrim të vjetër për mos përshkallëzimin e stokut të detyrimeve aktual.

Ne periudhën Gusht 2020 u bë funksionale Struktura e re Organizative me qëllim rritjen e efikasitetit dhe eficiencës operacionale në mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara. Struktura e re organizative konsolidoi funksionin e mbledhjes së detyrimeve të papaguara në 3 rajone, DMDTP Rajoni Qendror, DMDTP Rajoni Verior, DMDTP Rajoni Jugor dhe DMDTP Tatimpaguesit e Medhenj.

Me ristrukturimin e DMDTP, pavarësisht situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, është menaxhuar me efektivitet mbledhja e detyrimeve tatimore në përputhje me dispozitat ligjore duke moslejuar krijimin e detyrimeve të reja gjatë periudhës Gusht 2020-Dhjetor 2020.

Gjendja e detyrimeve të papaguara në afat në datë 01.08.2020	122.4 mld lek
--	---------------

Gjendja në datë 31 Dhjetor 2020	122.5 mld lek
---------------------------------	---------------

Gjatë periudhës Gusht 2020-Dhjetor 2020, detyrimet tatimore kanë pësuar një rritje neto 100 mil lekë ose thënë ndryshe është rritur stoku i detyrimeve me 0,08%, vlerë kjo relativisht e ulët krahasuar me periudhën Janar 2020- Gusht 2020.

Nga ana e Rajoneve të Mbledhjes ka vijuar zbatimi i procedurës së komunikimit me tatimpaguesit duke patur për qëllim vetpermbushjen vullnetare të detyrimeve të papaguara si dhe sqarimin e procedurave të mbledhjes me force të cilat do të vijojnë në zbatim të ligjit.

Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara në DPT ka monitoruar ecurinë e stokut të detyrimeve, ka kryer analizë të situatës së detyrimeve në nivel subjektësh dhe vecanërisht atyre më të mëdha, masave të ndermarra në lidhje me to në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

VIII. RIMBURSIMI I TVSH-SË

1. Objekti dhe detyrat e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së

Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së është struktura që merret me trajtimin, miratimin dhe kryerjen e procedurës së rimbursimit të TVSH-së në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale Tatimore, Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut në DPT dhe Drejtorinë TIK të Tatimeve.

Detyrat e Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së, janë si më poshtë vijon:

1. Të lehtësojë zbatimin me përpikmëri të legjislacionit tatimor në fushën e rimbursimit të TVSH-së si dhe unifikimin e procedurës së ndjekur lidhur me trajtimin e praktikave;
2. Të kryejë procedurën e rimbursimit të TVSH-së bazuar në analizën e riskut;
3. Të kryejë përveç procedurës së rimbursimit të TVSH-së bazuar në analizën e riskut edhe procedurën e rimbursimit të TVSH-së nëpërmjet sistemit të thesarit, nëse kërkesa për rimbursim TVSH-je është bërë:
 - nga organizatat jofitimprurëse për tvsh-në e paguar në blerje, për mallra të destinuara për eksport për përmbushjen e qëllimit si pjesë e veprimtarisë së tyre bamirëse jashtë Shqipërisë në kuadër të marrëveshjeve të posaçme;
 - nga çdo udhëtar jo i vendosur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë për blerje mallrash të destinuara për t'u transportuar në bagazhin personal të udhëtarëve;
 - në kuadër të marrëveshjeve financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose në kuadër të marrëveshjeve të granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, në të cilat parashikohet mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, në bazë të parimit të reciprocitetit për TVSH-në e paguar për blerjet brenda vendit nga misionet diplomatike, organizatat ndërkombëtare dhe personeli i tyre.

2. Baza Ligjore

Baza ligjore për rimbursimin e TVSH-së është e përcaktuar në:

1. Nenin 77 të Ligjit 92/2014 datë 27.4.2017 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH” i ndryshuar,

2. Nenin 62, 63 dhe 64 të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH”, i ndryshuar,
3. Nenin 75/1 të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Per Procedurat Tatimore ne RSH” i ndryshuar,
4. Pikën 75/1 të Udhëzimit Nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar,
5. VKM nr. 953, datë 29.12.2014, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" për qëllime të rimbursimit të TVSH-së, e ndryshuar,
6. Udhëzimin Nr. 19, datë 3.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të vecantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar” i ndryshuar,
7. “Rregulloren e Rimbursimit të TVSH-së mbështetur në analizën e riskut” dhe
8. “Manualin për rimbursimin e TVSH-së”.

Çdo person i tatueshëm, i cili plotëson kushtet e parashikuara në nenin 77 të ligjit 92/2014 "Për TVSH-në", ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e TVSH-së.

1. Një person i tatueshëm kërkon rimbursim të tepricës së kreditimit tatimor të TVSH-se nëse:
 - a) personi i tatueshëm ka mbartur tepricën e TVSH-së së zbritshme për 3 muaj radhazi, sipas pikave 2 dhe 3, të nenit 76, të këtij ligji;
 - b) TVSH-ja e kërkuar për t’u rimbursuar tejkalon shumën prej 400 000 lekësh.

Procedura e rimbursimit është e percaktuar ne nenin 75/1 të Ligjit nr. Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Per Procedurat Tatimore ne RSH” i ndryshuar dhe pikes 75/1 te Udhëzimit Nr.24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar.

Gjithashtu, brenda afatit ligjor 30 ditor, bazuar ne nenet 63 dhe 64 të Udhëzimit Nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH”, i ndryshuar, kryhet :

- Rimbursimi i TVSH-së për projektet e kryera në kuadër të marrëveshjeve financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose në kuadër të marrëveshjeve të granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave. **Neni 63**
- Rimbursimi i TVSH-së së paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve për projektet e kryera në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA I) dhe Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II). **Neni 63**
- Rimbursimi i TVSH-së së paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve, për misionet diplomatike dhe organizatat ndërkombëtare. **Neni 64**

3. Aktivitetet e realizuara për vitin 2020

Bazuar në planin e aktiviteteve për vitin 2020, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së ka realizuar aktivitetet kryesore të mëposhtme:

- I. Trajtimi dhe Rimbursimi i kërkesave për rimbursim të TVSH-se sipas afateve ligjore;
- II. Rishikimi i Rregullores së Rimbursimit të TVSH-së;
- III. Publikimi i Stokut të Rimbursimit të TVSH-së;
- IV. Automatizimi i sistemit të trajtimit të kërkesave për rimbursim.

3.1 Trajtimi dhe Rimbursimi i kërkesave për rimbursim të TVSH-së sipas afateve ligjore;

Ecuria e treguesve të rimbursimit për vitin **2020** është si më poshte:

Kerkesat: Gjate periudhes Janar - Dhjetor 2020, prane DRTVSH-se jane regjistruar **1.476 kërkesa** për rimbursim (nga 1273 kërkesa të regjistruara në 2019), me vlerë totale **21,621 milion leke** (nga 26,252 milion leke në 2019). Gjithsej **jane pranuar 1,068 kërkesa** (nga 983 kërkesa të pranuar në 2019), me vlerë **15,556 milion leke** (nga 22,707 milion leke në 2019, dhe **408 kërkesa** me vlerë **6,065 milion leke** (nga 290 kërkesa në 2019, me vlerë 3,545 milion leke), **nuk jane pranuar** për mosplotësim të kriterëve ligjore.

- Nga 1,068 kërkesa të pranuar, **65 kërkesa** me vlerë **443 milion leke** janë bërë nga tatimpagues të klasifikuar si eksportues me Risk Zero, kërkesa e të cilëve duhet të miratohen dhe rimbursohet automatikisht brenda 30 ditëve nga data e kërkesës;
- Nga 1,068 kërkesa të pranuar, **580 kërkesa** me vlerë **7,552 milion leke** janë bërë nga tatimpagues të klasifikuar si eksportues, kërkesa e të cilëve duhet të miratohet dhe rimbursohet brenda 30 ditëve nga data e kërkesës;
- Nga 1,068 kërkesa të pranuar, **423 kërkesa** me vlerë **7,561 milion leke** janë bërë nga tatimpagues të klasifikuar si jo-eksportues, kërkesa e të cilëve duhet të miratohet dhe rimbursohet brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, me raport kontrolli.

Rimbursimet: Gjate periudhes Janar - Dhjetor 2020, janë rimbursuar në total (FIFO + Kestë) **16,508 milion leke**, rreth **30 % më pak se në 2019** (nga 23,509 milion leke të rimbursuar në 2019) dhe rreth **21 % më pak se plani 2020** (21,000 milion leke). Pjesa më e madhe vlerës së rimbursuar (rreth 63 %) është dhënë për tatimpaguesit e DTM (ndikuar nga tatimpaguesit e trajtuar jo FIFO).

Nr.	Rimbursuar sipas DRT-ve		
	DRT Tatimore	Numri i Kërkesave	Vlera e Rimbursuar (000 leke)
1	BERAT	52	339,840
2	DIBER	19	623,942
3	DURRES	245	1,023,624
4	ELBASAN	42	480,043
5	FIER	101	872,629
6	GJIROKASTER	16	47,279
7	KORCE	61	344,687
8	KUKES	2	49,942
9	LEZHE	11	84,384
10	SARANDE	15	81,898
11	SHKODER	41	182,602
12	TIRANE	185	1,738,169
13	DTM	214	10,409,577
14	VLORE	58	229,186
TOTALI		1,062	16,507,804

Jane miratuar dhe rimbursuar **1.008 kërkesa** te trajtuara sipas metodës FIFO me vlerë totale **8,942 milion leke**. Te gjitha kërkesat FIFO te miratuara per periudhën Janar - Dhjetor 2020 jane rimbursuar ne kohe, duke bere qe mos te kemi stok te kërkesave nen 150 milion leke ne fund te vitit 2020. Pagesa e tatimpaguesve jo FIFO ka vijuar duke rimbursuar me keste ne total **7,566 milion leke** per periudhën Janar - Dhjetor 2020.

Koha e Rimbursimit: Ne lidhje me kohen e procesimit (koha mesatare e miratimit te kërkesës per rimbursim te TVSH-se, nga data e kërkesës deri ne datën miratimit te kërkesës), per periudhën Janar - Dhjetor 2020, jane miratuar dhe rimbursuar **1.008 kërkesa FIFO**, koha mesatare e procesimit ka qene **70 dite**, ku **27 %** te kërkesave jane procesuar brenda **30 diteve**.

Rreth **59 %** e kërkesave jane procesuar brenda afatit **60-ditore**.

Duhet theksuar se **13 %** e kërkesave jane procesuar mbi **120 dite** dhe kryesisht arsyeja ka qene mospagimi i detyrimeve per **“1900, Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore”**, nga ana e tatimpaguesve. Po te perjashtojme kërkesat e procesuara ne mbi **120 dite**, te cilat jane kryesisht per faje te tatimpaguesit, koha mesatare e procesimit do te ishte **51 dite** nga **70 dite**.

Dite	<31	31-60	61-90	91-120	>120	Total
Numer	269	325	190	94	130	1008
%	27	32	19	9	13	100

Duhet theksuar se gjate vitit 2020, rimbursimi i TVSH-se, (koha mesatare e Rimbursimit te kerkeses per rimbursim te TVSH-se, nga data e kerkeses deri ne daten e kalimit ne thesar), eshte bere mesatarisht ne rreth **83 dite** nga **170 dite** qe ishte ne vitin 2019.

Stoku me 31.12.2020: Stoku i rimbursimeve per kerkesat e miratuara dhe te pa likujduara nga administrate tatimore, ne date 31.12.2020, ishte **9,797,309,171 leke**, ku rreth 73 % e vleres perbehet nga detyrimi per tatimpaguesin TAP:

Kerkesat ne proces: Deri ne date 31.12.2020 ne Drejtorine e Rimbursimit rezultojne se jane ne proces ne total rreth **245 kerkesa** ne vlere **4,679 milion leke**:

Kerkesat ne proces sipas te regjistruara sipas viteve		
Viti	Numri i kerkesave	Vlera e Kerkesave (milion leke)
2017	1	5
2018	1	3
2019	9	180
2020	233	4,491
Total	245	4,679

Marreveshjet me Keste: DPT, ne mbeshtetje te ligjit Nr.9920, date 19.05.2008, "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, si dhe te VKM Nr. 146, date 13.02.2020 "per procedurat dhe kriteret e marreveshjes per pagesen me keste te Tatimit mbi Vleren e Shtuar, te miratuar per rimbursim", ka miratuar Urdherin, Nr 20, date 02.03.2020, per miratimin e formatit te projekt-marreveshjes "Per Pagesen me Keste te Tatimit mbi Vleren e Shtuar, te Miratuar per Rimbursim".

Aktualisht eshte arritur marreveshje me tatimpaguesit:

- **AYEN AS ENERGY me NIPT L11731504A;**
- **BANKERS PETROLEUM ALBANIA Shpk, me NIPT K43128401L;**
- **ALBCONTROL Sha me NIPT J61908011H;**
- **HYDRO SETA me NIPT L31528016T;**
- **ALMARINA OR Shpk me NIPT L56506204C;**
- **KILIC AQUACULTURE ALBANIA Shpk me NIPT L43403601A;**

Per te gjitha kerkesat e tjera te miratuara te cilat plotesojne kriterin ligjor per t'u trajtuar sipas marreveshjes me keste jane ne proces.

3.2 Rishikimi i Rregullores së Rimbursimit të TVSH-së;

Gjate vitit 2020 u rishikua dhe miratua Rregullorja e Rimbursimit të TVSH-së me nr.7158/1 datë 28.04.2020. Rishikimi u fokusua lehtësimin e kriterëve të riskut të aplikuar nga DMR (numri i kriterëve të riskut të thyera për ta klasifikuar kërkesën për rimbursim si kerkese me Risk, kaloi mbi 3 kriterë të thyera nga 1 kriter që ishte me pare). Gjithashtu, u thjeshtua/lehtësua skema e analizës manuale të riskut që aplikon DRTVSH dhe u fut në procedurë shkëmbimi i informacionit me Drejtorinë e Hetimit Tatimor për parandalimin e skemave të mashtrimit me TVSH-se duke klasifikuar me Risk kërkesat e bera nga tatimpagues të cilët janë referuar në Prokurori nga DHT. Qëllimi i ketyre ndryshimeve ishte:

- Ulja e numrit të kërkesave të cilat çohen për kontroll, duke ndryshuar hapat dhe kriteret e analizës së riskut.
- Orientimin e me shumë kërkesave drejt kontrolleve nga zyra sesa kontrolle në vend, duke ulur kohën e mbylljes së kontrolleve.
- Ulja e afatit kohor të shkëmbimit të informacionit ndërmjet DRTVSH dhe drejtorive të tjera në DPT, duke kaluar informacionin në mënyrë elektronike (email) nga shkresorë që ishte në rregulloren e vjetër.
- Parandalimi i rimbursimit për skemat e mashtrimit. Tatimpaguesit që ka bërë kërkesën për rimbursim për të cilët kanë filluar veprime hetimore nga strukturat kompetente, bazuar në dyshimet të konsumimit të vepres penale të fshehjes së të ardhurave apo evazionit fiskal, kërkesa për rimbursim dërgohet për kontroll në vend sepse klasifikohet me Risk dhe/ose pezullohet.

Kërkesat e trajtuara me rregulloren e re (hyrë në fuqi me datë 28.04.2020) dërgohen për kontroll (kërkesat që pas analizës së riskut rezultojnë për kontroll), mesatarisht rreth **6 dite** pas datës së kërkesës nga mesatarisht rreth **11 dite** që dërgoheshin me rregulloren e mëparshme, si rezultat të ndryshimit të shkëmbimit të informacionit ndërmjet DRTVSH dhe drejtorive të tjera në DPT, duke kaluar në mënyrë elektronike (email) nga shkresorë që ishte në rregulloren e mëparshme.

Nga kërkesat e trajtuara me rregulloren e re të cilat pas analizës së riskut rezultojnë për kontroll, rreth **38%** janë çuar për **Kontroll nga Zyra** dhe rreth **62%** janë çuar për **Kontroll në Vend**, ndryshe nga kërkesat e trajtuara me rregulloren e mëparshme ku rreth **9%** janë çuar për **Kontroll nga Zyra** dhe rreth **91%** janë çuar për **Kontroll në Vend**. Pra, kërkesat e trajtuara me rregulloren e re (hyrë në fuqi me datë 28.04.2020) orientojnë me shumë kërkesa me Kontroll nga Zyra dhe me pak në Kontroll në Vend duke minimizuar kontaktet direkte të inspektorëve me tatimpaguesin dhe duke shkurtuar kohën e kontrollit (kontrolli nga zyra mbyllet në afatet më të shkurtra kohore);

3.3 Publikimi i Stokut të Rimbursimit të TVSH-së

Në zbatim të urdherit Nr. 28, datë 08.04.2020, nr. 6380 Prot, në mbështetje të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së çdo tre muaj përgatit dhe publikon një raport të detajuar statistikor lidhur me ecurinë e procesit të rimbursimit për tremujorin për treguesit:

- Numrin e përgjithshëm të kërkesave të trajtuara;
- Numrin e kërkesave të refuzuara;
- Vlerën e rimbursimeve të ndara sipas tatimpaguesve me keste dhe FIFO;
- Stokun e rimbursimeve të detajuar sipas tatimpaguesve me keste dhe të tjere.

Publikimi i parë u bë në datë 06.04.2020, në website të DPT.

3.4 Automatizimi i sistemit të trajtimit të kërkesave për rimbursim.

Platforma dixhitale e rimbursimit e cila pritet të vihet në funksion në fillim të vitit 2021, do të ul kohën e trajtimit të kërkesave duke garantuar trajtimin sipas radhës dhe do të mundësojë gjurmimin e kërkesës në çdo kohë dhe llogaritjen e kamatvonesave (interesi) për kërkesat e miratuara dhe të përblyera në kohë. Gjate vitit 2020 janë mbajtur komunikime me kompaninë zhvilluese lidhur me implementimin e platformës ku është specifikuar workflow që duhet të ndiqet si dhe janë dhënë përgjigje të gjitha pyetjeve të ngritura nga përfaqësuesit të kompanisë zhvilluese të platformës.

IX. HETIMI TATIMOR

Drejtoria e Hetimit Tatimor ushtron detyrat e saj në kuadër të parandalimit, zbulimit dhe hetimit, në përputhje me ligjin e procedurave tatimore dhe legjislacionin penal apo procedural penal, të kundravajtjeve administrative tatimore apo veprave penale në fushën e taksave dhe tatimeve.

Gjatë vitit 2020, bazuar në objektivat strategjikë të hartuara dhe miratuara si dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi, Drejtoria e Hetimit Tatimor ka punuar dhe realizuar detyrat funksionale në zbatim të performancës së Administratës Tatimore në funksion të mbledhjes dhe realizimit të të ardhurave buxhetore dhe parandalimit të rasteve të evazionit tatimor.

Rezultatet e Drejtorisë së Hetimit Tatimor bazuar në Manualin e Hetimit Tatimor, Rregulloren “Për funksionimin e Administratës Tatimore Qendrore”, Ligjin Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë në zbatim të tij, si dhe në zbatim të objektivave të Planit Strategjik 2017-2021, kanë konsistuar në këto drejtime:

- ✓ Analiza paraprake hetimore e tatimpaguesve me risk, mbi bazën e kriterëve të thyera të riskut, dhe analizës së sektorve prioritar sipas aktiviteteve të përcaktuar në sektorët:
 - Ndërtim, Tregti karburanti, artikujsh farmaceutik dhe Call Center, gjithsej **52** subjekte.
 - Tregti karburanti, janë përzgjedhur **190** subjekte.
 - Tregti artikujsh farmaceutik, janë përzgjedhur **80** subjekte.
 - Ndërtim dhe infrastrukturë, si blerës të mëdhenj karburanti, tregëtim gazi. Janë përzgjedhur **202** subjekte.
 - Studio kontabiliteti. Gjithsej **12** studio dhe rreth **704** subjekte. Dërgim informacioni i përmbledhur me problematikat e konstatuara në Sektorin e analizës së riskut në DMR.
 - Përmbarues privat”, Gjithsej **3** subjekte.
- ✓ Administrimi, ndjekja e kërkesave të ardhura në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, nga Institucione të ndryshme apo Prokuroritë, Gjykata, Drejtoritë e Policive, OFL, KLP, etj, brenda afateve. Gjithsej **1580** shkresa.

Shkresa të trajtuara sipas ligjit për informacioni e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të thjeshta dhe të klasifikuara (DPPP dhe RAD) 151 total.

Denoncime/ankesa

Trajtim i denoncimeve/ ankesave është pjesë e detyrave funksionale të strukturave të Hetimit Tatimor. Ndjekja e ankesave bëhet brenda një kohe sa më të shkurtër duke ruajtur të dhënat konfidenciale të denoncuesit.

Spektori i Administrimit të Informacionit dhe Analizës ka administruar denoncimet e ardhura në formë të ndryshme në periudhën Janar- 12 Maj 2020, të dhënat e të cilave po i paraqesim më poshtë:

Tabela 1. Ndjekja e denoncimeve

Forma e denoncimit	Nr. i denoncimeve të ardhura	Nr. i denoncimeve të trajtuara	Me Penalitet
Platforma Bashkqeverisjes	41	31	11
E-mail (denoncime@tatime.gov.al)	73	47	14
Telefon-Takim (0800 14 14)	447	217	97
Tableti Whats App, Viber 0697073733	29	14	3
TOTAL	590	309	125

Gjatë periudhës Janar- 12 Maj 2020, pranë Drejtorisë së Hetimit Tatimor kanë mbërritur nga burime të ndryshme rreth 590 raste denoncimesh prej të cilave janë ezauruar 309 dhe nga denoncimet e trajtuara në fund të kontrolleve të ushtruara janë konstatuar rreth 125 shkelje tatimore.

Strukturat e Hetimit Tatimor, vijojnë me verifikimet për rastet e tjera deri në trajtimin e plotë të tyre.

Referime për veprat penale Janar- Dhjetor 2020


Gjatë vitit 2020, Drejtoria e Hetimit Tatimor është angazhuar në parandalimin dhe zbulimin e rasteve të evazionit fiskal. Në lidhje me këtë janë arritur rezultatet si më poshtë:

Tabela nr. 2, Referime në prokurori (total)


Janar - Dhjetor 2020				
Nr	Vepra penale	Neni K.P	Nr. Ref	VLERA
1	Krijimi i skemave mashtruese me TVSH	144/a	5	1,087,293,225.00
2	Fshehje e të ardhurave	180	71	1,472,175,018.00
3	Mospagim taksash e tatimesh	181	85	1,937,086,955.00
5	Punësim i paligjshëm	170/a	8	
6	pezullimit të veprimtarisë tregtare	182/a	16	
7	Të tjera (287, etj)		9	619,383,400.00
	Shuma		194	5,115,938,598

Sektori i Hetimit ka referuar në Prokurori 194 raste me vlerë të dyshuar të evazionit 5,115,938,598 lekë.

Grafik 2. Referime të veprave penale në prokurori ndër vite



Grafik 3. Referimet e rasteve sipas prokurorive



Drejtoria e Hetimit Tatimor ka kryer propozime për vlerësim të situatës financiare dhe propozime për kontroll për 318 raste.

Zbatimi i Rekomandimeve të FMN dhe TADAT

Rekomandimet e FMN-së, janë prioritet për t'u ndjekur nga Drejtoria e Hetimit Tatimor gjatë vitit 2021.

Detyrat funksionale të Drejtorisë së Hetimit Tatimor janë kryer në përputhje me rekomandimet e TADAT, të cilat vijojnë të mbeten prioritet edhe gjatë vitit 2021, ndër të tjera janë si më poshtë:

- “Mbështetja e pajtueshmërisë vullnetare”.
- “Deklarimi në kohë i tatimeve”.
- “Informacion i saktë dhe i besueshëm për tatimpaguesit”.
- "Integriteti i bazës tatimpaguese të regjistruar".

X. MARRËDHËNIET DHE KOORDINIMI INSTITUCIONAL DHE MENAXHIMI I PROJEKTEVE

Përshkrim i shkurtër i DMJMP (dhe DMKN me strukturën e vjetër organizative)

Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Koordinimit të Projekteve (DMJMP) është në varësi të zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Mbështetjes së Programeve.

DMJMP organizon dhe koordinon marrëdhëniet dhe bashkëpunimin dypalësh të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me organizma ndërkombëtarë, në zbatim të aktiviteteve të Administratës Tatimore Shqiptare; siguron harmonizimin dhe koordinimin e të gjitha projekteve me financim të brendshëm apo të huaj që zhvillohen në Administratën Tatimore Shqiptare dhe që ndërlidhen me bashkëpunimin vendas apo ndërkombëtar, përfshirë Administratat Tatimore, Organizatat Ndërkombëtare.

Drejtoria e Marrëdhënieve dhe Koordinimit Ndërinstitucional (DMKN) është në varësi të zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Mbështetjes së Programeve.

DMKN organizon dhe koordinon marrëdhëniet dhe bashkëpunimin dypalësh të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me organizma ndërkombëtarë, në zbatim të aktiviteteve të Administratës Tatimore Shqiptare; siguron zbatimin e drejtë të marrëveshjeve ndërkombëtare tatimore për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin, të ratifikuara nga Parlamenti, si dhe garanton mbrojtjen e interesave të tatimpaguesve shqiptarë në raport me transaksionet dhe marrëdhëniet me administratat tatimore të huaja.

Detyrat funksionale

Detyrat funksionale të DMKN-së janë:

- Sigurimi i mbarëvajtjes së bashkëpunimit dhe marrëdhënieve dypalëshe të administratës tatimore me organizmat vendase dhe të huaja.
- Raportimi në strukturat e linjës lidhur me proceset e integritetit të vendit në BE.

- Sigurimi i zbatimit korrekt, të paanshëm dhe jodiskriminues të legjislacionit tatimor dhe marrëveshjeve tatimore ndërkombëtare për eliminimin e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal.
- Ndjekje dhe asistim në nivel teknik për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në negociatat për marrëveshjet tatimore.
- Sigurimi i shkëmbimit të informacionit (spontan / me kërkesë) me vendet me të cilat Shqipëria ka një marrëveshje tatimore në fuqi si dhe me vendet anëtare të Forumit Global të OECD.

Detyrat funksionale të DMJMP -së janë:

- Koordinon punën për mirëfunksionimin e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Menaxhimit të Projekteve në DPT.
- Propozon dhe harton kërkesat për asistencë ndërkombëtare.
- Bashkërendon punën me Drejtoritë e tjera në DPT dhe Drejtoritë Rajonale për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve me financim të brendshëm apo të jashtëm dhe menaxhon marrëdhëniet dypalëshe me administratat homologe dhe partnerët e huaj.
- Menaxhon formulimin dhe zbatimin e planeve operacionale vjetore të Drejtorisë, merr raporte lidhur me zbatimin e tyre nga punonjësit në varësi dhe përgatit raporte periodike ku përmbledh realizimin e detyrave kundrejt planit.
- Bashkërendon punën me Drejtoritë e tjera në DPT dhe Drejtoritë Rajonale për pjesëmarrjen e personelit të Administratës Tatimore Qendrore në programet dhe trajnimet e zhvilluara nga organizmat ndërkombëtare si dhe në vizitat e kryera në kuadër të bashkëpunimit dypalësh.
- Përgatit dhe zbaton strategjinë menaxhuese dhe planet operacionale në kuadër të integritetit evropian, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe në fushën e projekteve të asistencës për Administratën Tatimore.
- Informon në mënyrë periodike drejtuesit më të lartë mbi zbatimin e politikave, problematikat që dalin, nevojën për të ndërhyrë për zgjidhje të mundshme kur kompetenca është në nivel më të lartë për t'u zgjidhur.

Struktura

Me ndryshimet e strukturës më të fundit organizative të DPT, prej muajit korrik 2020 DMJMP përbëhet nga 1 Drejtor + 2 përgjegjës sektori + 6 inspektorë.

Stafi aktual

- Sektori i Koordinimit të Projekteve: 2 inspektorë.
- Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë: 1 përgjegjës sektori; 3 inspektorë; 1 vend vakant.

Objektivat për vitin 2020

Objektivat e DMKN-së për vitin 2020:

Objektivi strategjik 1: Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare

1.1 Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe reduktimi i barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore.

1.3 Zbatimi i metodologjive dhe praktikave njëhsuese

Objektivi strategjik 2: Zbatimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor

2.2 Përmirësimi i mëtejshëm i kontrollit tatimor dhe gjurmimi i mashtrimeve tatimore

Objektivi strategjik 3: Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore.

3.1 Aplikimi i metodave dhe sistemeve për të menaxhuar një AT moderne

3.4 Zhvillimi dhe përmirësimi i partneriteteve

Treguesit kryesore të performancës

- Trajtim cilësor dhe në kohë sa më të shkurtër i kërkesave të tatimpaguesve për zbatimin e marrëveshjeve të eliminimit të taksimit të dyfishtë,
- Kontribut në grupin e punës të ngritur për zbatimin e projektit pilot mbi Shkëmbimin Automatik të Informacionit sipas standardeve të OECD.
- Përmirësimi i njohurive të stafit, përmes pjesëmarrjes sa më të gjerë në trajnimet e organizuara nga organizatat ndërkombëtare, vizitave studimore në administratat homologe apo sjelljes së ekspertëve të huaj të fushave të caktuara.
- Menaxhimi dhe koordinimi i kontributit të DPT në procesin e integritetit në BE.

Aktivitetet e programuara dhe realizuar gjatë 2020 në funksion të realizimit të objektivave.

Sektori i Marrëveshjeve dhe Eliminimit të Taksimit të Dyfishtë (Janar-Korrik 2020)

Në kuadër të ofrimit të shërbimeve cilësore për tatimpaguesit ky Sektor:

- Iu është përgjigjur mbi **1,200 kërkesave** nga tatimpaguesit për zbatimin e marrëveshjeve tatimore ndërkombëtare për shmangien e taksimit të dyfishtë, që Shqipëria ka lidhur me 40 shtete;

- Iu është përgjigjur mbi **180 kërkesave** të tatimpaguesve dhe individëve për t'u pajisur me çertifikatë rezidence;
- **35 kërkesa** për shkëmbim informacioni nga / drejt administratave tatimore homologe.
- Ka dhënë kontribut për grupin e punës të ngritur në kuadër të Projektit Pilot për Shkëmbimin Automatik të Informacionit, që u zbatua (2018-2020) me ndihmesën e OECD dhe Administratës Tatimore Italiane;

Spektori i Koordinimit të Projekteve (DMKN - Janar-Korrik 2020) / Spektori i Marrëdhënieve me Jashtë (DMJMP - Korrik-Dhjetor 2020)

Në kuadrin e shkëmbimit të eksperiencave, studimit dhe zbatimit të praktikave më të mira ndërkombëtare në lidhje me sistemet e menaxhimit, ka organizuar pjesëmarrjen e stafit të Administratës Tatimore në aktivitetet si vijon:

- o 4 forume online (19 punonjës të trajnuar) organizuar nga *Organizata Ndër-Europiane e Administratave Tatimore (IOTA)*.
- o 3 webinare/trajnime online (8 punonjës të trajnuar) organizuar nga *Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD)*.
- o 4 webinare/trajnime online (7 punonjës të trajnuar) organizuar nga Qendra e Ekselencës Financiare (CEF).
- o 1 trajnim online (2 punonjës të trajnuar) organizuar në kuadër të programit të BE **Fiscalis 2020**.
- o 3 trajnime online (3 punonjës të trajnuar) organizuar nga FMN
- o Në kuadër të programit **TAIEX** është organizuar *online*, 1 mision me ekspertë të huaj, që kanë asistuar Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve: “Përmirësimi i perceptimit të tatimpaguesve”, Tetor 2020- 30 pjesëmarrës (DPT+DRT).

U organizua pjesëmarrja në Takimin Bilateral ndërmjet Administratës Tatimore të Maqedonisë së Veriut dhe AT Shqiptare, mbi rimbursimin e TVSH-së, skemat e sigurimeve shoqërore, incentivat për zonat e lira ekonomike, në Janar 2020, Shkup, Maqedoni e Veriut.

- o Raportim në strukturat e linjës lidhur me proceset e integritimit në BE; përgatitja e informacioneve mbi progresin e Administratës Tatimore Shqiptare në kuadër të:
 - ✓ Kontributi II^{të} dhe i III^{të} për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020.
 - ✓ Takimi i Nënkomitetit “Tregti, Industri, Tatime, Dogana” (takim *online*), 27 Maj 2020.

- ✓ Kapitulli 16 “Tatimet”, Kapitulli 33 “Kriteri Ekonomik”, Kapitulli 20 “Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale”.
- ✓ Raportim në kuadër të PKIE (Planit Kombëtar të Integritimit).
- ✓ Takimi i 11^{të} i KSA “Komiteti i Stabilizim Asociimit”, 9 dhjetor 2020 (videokonferencë).
- ✓ Takimi i 12^{të} i Nënkomitetit Çështjet Ekonomiko-Financiare dhe Statistikat, 11-13 Nëntor 2020 (videokonferencë).
- ✓ Raportimi i përvitshëm “*Doing Business*” (indikatori Paying Taxes) i Bankës Botërore.
- ✓ Raportimi për Monitorimin 6-mujor të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike - PFM Action Plan, për Komponentin 3.1 “*Tax Administration*”.

Në përmbushje të nën-objektivit 3.1: “Aplikimi i metodave dhe sistemeve për të menaxhuar një Administratë Tatimore Moderne”, si pjesë e objektivit 3: “Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore”, ka organizuar dhe ndjekur vizitat nga ekspertë të jashtëm me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe zbatimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në lidhje me sistemet e menaxhimit. Konkretisht, aktivitete e realizuar, renditen si më poshtë:

1. Takim me përfaqësuesit e Bankës Botërore më datë 04.02.2020

- Diskutim mbi iniciativat e vazhdueshme të komunikimit në DPT, boshllëqet dhe hapat e planifikuar nga DPT në vazhdim.
- Informimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi i tatimpaguesve:
- Diskutimi paraprak i ndërhyrjeve / eksperimenteve të mundshme që BB mund të ndihmojë për të filluar

2. Misioni të ekspertëve të FMN:

- Konsolidimi i funksioneve të Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara – shkurt 2020
- Asistencë në përmirësimin e menaxhimit të riskut të përmbushjes tatimore – shkurt 2020

Projekti për Shkëmbimin Automatik të Informacionit

Në përmbushje të nën-objektivit 3.3: “Mbajtja e proceseve optimale dhe struktura e Administratës Tatimore”, si pjesë e objektivit 3: “Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore”, ka ndjekur zbatimin e projektit “Shkëmbimi Automatik i Informacionit”. Ky projekt bazohet në Ligji Nr. 146/2013, datë 06.05.2013 “Për Ratifikimin e Konventës për Ndihmën Administrative të Ndërsjellë në Çështjet Tatimore”, i cili në nenin 6 të tij ka parashikuar që vendet

shkëmbejnë automatikisht informacionin tatimor si dhe në “Marrëveshjen Shumëpalëshe të Autoriteteve Kompetente për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarive Financiare”, nënshkruar më datë 29.10.2014, miratuar me VKM Nr. 178, datë 09.03.2016.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në adoptimin dhe zbatimin e Shkëmbimit Automatik të Informacionit në llogaritë financiare për qëllime tatimore, sipas standardeve të përbashkëta të raportimit.

Informacioni për t’u shkëmbyer përfshin llogaritë financiare, duke përfshirë bilancet, interesat, dividendët, të drejtat dhe të ardhurat nga shitja e aseteve financiare të raportuara të qeveritë nga institucionet financiare, duke mbuluar llogaritë e mbajtura nga individët dhe entitetet përfshirë trustet dhe fondacionet.

Gjatë viti 2020 është miratuar Ligji nr. 4/2020, “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”, si dhe VKM përkatëse Nr. 613, datë 29.7.2020 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 4/2020, “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”.

Gjatë kësaj periudhe është organizuar 1 takim i Komitetit Drejtues, me qëllim diskutimin mbi problematikat e hasura gjatë periudhës së zbatimit si dhe ecurinë e projektit.

Gjithashtu si mjet për të monitoruar zbatimin e projektit kanë qenë edhe disa *conference call* zhvilluar ndërmjet DPT, OECD dhe palës italiane, si dhe takimet periodike të grupit të punës në DPT.

U hartuan Termat e Referencës për ngritjen e sistemit informatik; u kryen procedurat për tenderimin e sistemit dhe u realizua ngritja e sistemit nga kompania.

Pas ngritjes së sistemit dhe marrjes së vlerësimit (për shkëmbim jo-reciprok) nga OECD mbi konfidencialitetin e të dhënave në DPT, gjatë muajit dhjetor u krye dërgimi i të dhënave të raportuara nga institucionet financiare në Shqipëri, subjekt i Ligjit nr. 4/2020, drejt autoriteteve tatimore homologe.

Projekti i Fiskalizimit

Duke filluar nga data 27.11.2018 ka filluar implementimi i Projektit “Përmirësimi i Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit”, njohur ndryshe si Projekti i Fiskalizimit. Ky projekt shënon një reformë të thellë në raportimin fiskal dhe administrimin tatimor të të dhënave.

Procesi i Fiskalizimit mundëson që procedurat e inspektimit tatimor të jenë transparente dhe efikase, duke e bërë kontrollin tatimor më efikas; rritje të ndërgjegjësimit për rëndësinë e kësaj çështjeje dhe zhvillimin e tregut të shërbimeve të IT-së, duke krijuar kushtet për konkurrencë të barabartë në treg.

Fiskalizimi është i bazuar në *software* dhe procesi mund të implementohet lehtësisht në të gjitha paisjet ekzistuese fiskale (pa pasur nevojë për një pajisje *software* sekondare vetëm për të operuar brenda sistemit të fiskalizimit). Në terma afatgjatë kjo ul ndjeshëm kostot e teknologjisë për tatimpaguesit.

Me këtë sistem do të kemi pasqyrë dhe monitorim në kohë reale të transaksioneve financiare, analizë të detajuar dhe parashikuese; analizë të riskut sipas modelit matricor duke përdorur të gjitha të dhënat e disponueshme nga AT në mënyrë proaktive.

Referuar Ligjit Nr.87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", zbatimi i tij sipas fashave dhe llojit të transaksioneve, do të bëhet si më poshtë:

- Për transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve dhe organeve publike (**B2G**), efektet e këtij ligji fillojnë më 1 janar 2021.
- Për transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve (**B2B**), efektet e këtij ligji fillojnë më 1 korrik 2021.
- Për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit (**B2C**), pavarësisht përgjegjësisë tatimore apo qarkullimit vjetor të realizuar, efektet e këtij ligji fillojnë më 1 shtator 2021.

Çdo modul i implementuar është bazuar mbi dokumentet e kërkesave funksionale dhe teknike të përgatitura nga pala zhvilluese e projektit, të cilat i janë vënë në dispozicion drejtorive përkatëse për çdo rast të lidhjes së drejtpërdrejtë të modulit me funksionet e secilës, me qëllim njohjen dhe paraqitjen e çdo vërejtje, sugjerim apo kërkesë shtese dhe pas çdo implementimi nga ana e tyre janë realizuar seanca prezantimi dhe *workshop*-e me përfaqësues nga drejtoritë respektive.

Për sa më sipër, modulet/aktivitetet e finalizuara gjatë viti 2020 janë:

- Kuadri legjislativ (Ligji Nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" dhe aktet nënligjore në funksion të tij).
- Organizimi dhe metodologjia e monitorimit tatimor të tatimpaguesve në sistemin e transaksioneve me para në dorë.
- Zhvillimi dhe zbatimi i sistemeve për transaksionet me para në dorë.

- Portali Qendror për Kontrollimin dhe Menaxhimin (PQKM) e Tatimpaguesve për transaksionet me para në dorë.
- Sistemi i Menaxhimit të Riskut (SMR) për sistemin e transaksioneve me para në dorë.
- Monitorimi nga zyra nëpërmjet raporteve dhe të dhënave nga moduli *Business Intelligence* i tatimpaguesve në sistemin e transaksioneve me para në dorë.
- Aksesimi dhe monitorimi nëpërmjet tabletit për procesverbalin dhe kontrollin e të dhënave nga *website* në kohë reale.
- Zhvillimi dhe zbatimi i sistemit për transaksionet pa para në dorë (Fatura elektronike)

Përsa i përket planit të komunikimit dhe trajnimeve:

- Ka përfunduar organizimi i trajnimeve për stafin e Administratës Tatimore dhe për tatimpaguesit për kuadrin ligjor.
- Janë zhvilluar trajnime për tatimpaguesit (subjekte private dhe ente publike) për transaksionet B2G me fokus përdorimin e platformës Self-Care dhe Faturës Elektronike (te cilat po vazhdojnë edhe gjatë vitit 2021).
- Në kuadër të informimit të tatimpaguesve (subjekteve private dhe ente publike) ka pasur komunikime të vazhdueshme nëpërmjet publikimeve në website-et e MFE-së dhe DPT-së, rrjeteve sociale, mediave vizive (intervista dhe kronika) dhe se tatimpaguesit janë informuar në mënyrë të vazhdueshme edhe nëpërmjet portalit e-filing, përkrah trajnimeve të vazhdueshme të organizuara nga Administrata Tatimore.

Bazuar në kuadrin ligjor të miratuar për certifikimin e kompanive prodhuese dhe mirëmbajtëse të zgjidhjeve *software*-ike, është në vijim procesi i certifikimit të këtyre kompanive nga ana e DPT-së në bashkëpunim me AKSHI-n, si për transaksionet me para në dorë, ashtu edhe transaksionet pa para në dorë (faturën elektronike). Kjo ndikon në hapjen e tregut dhe shkuarjen drejt konkurrencës së lirë, marrë në konsideratë që në tregun paraprak të tregtimit të pajisjeve fiskale ka pasur vetëm 4 kompani të autorizuar për tregtimin e tyre.

Aktivitete jo të parashikuara në planifikimin fillestar, por të realizuara gjatë vitit 2020

DMKN: U hartua një përmbledhje e eksperiencës së vendeve të tjera mbi programet e deklarimit vullnetar të parregullsive lidhur me juridiksionet offshore, që iu përcoll Drejtorisë Kontrollit dhe asaj Ligjore për hartim propozimesh për ndryshime ligjore.

Sa dhe si ndikuan këto aktivitete në arritjen e objektivave të përcaktuara.

U realizua me sukses angazhimi i qeverisë shqiptare për kryerjen në vitin 2020 të shkëmbimit të parë automatik të informacionit me administratat homologe.

U përmirësua ndjeshëm koha mesatare e kthimit të përgjigjes drejt tatimpaguesit.

XI.BURIMET NJEREZORE

STRUKTURA ORGANIZATIVE

Administrata Tatimore Qendrore, deri në 12.02.2020, ushtronte funksionimin e saj në zbatim të Strukturës Organizative të miratuar me **Urdhrit nr. 86, datë 03.05.2019, të Kryeministrit "Për disa ndryshime në urdhrin nr.126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore" të ndryshuar;**

Struktura organizative e miratuar me Urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore”, solli ndryshime në organizimin e strukturës së Administratës Tatimore Qendrore.

Ndryshimet strukturore, në zbatim të Urdhrit nr.33, datë 12.02.2020 , të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore", erdhën si pasojë dhe në zbatim të Rekomandimeve të FMN-së dhe Rekomandimeve të KLSH-së, të cilat nuk ndikuan në numrin e përgjithshëm të personelit të ATQ, mbeten 1450 numër plan punonjësish/nëpunësish, prej të cilëve 1122 janë nëpunës civil dhe 328 janë punonjës të cilët trajtohen me dispozita të Kodit të Punës.

Në kuadër të implementimit të Projektit të Fiskalizimit, si dhe të rekomandimeve të FMN dhe gjithashtu për mirëfunksionim dhe efikasitet të Administratës Tatimore, u konstatuan të nevojshme ndryshime strukturore të cilat do të duhet të ishin në funksion të përmirësimit funksional dhe organizativ.

Projekti i Fiskalizimit kërkonte domosdoshmërisht ndryshime strukturore në strukturat e kontrollit tatimor dhe monitorimit territorial, keto te fundit si pjesë aktuale e Drejtorisë së Hetimit Tatimor.

Ishin domosdoshmëri ndryshimet strukturore në strukturat e kontrollit tatimor dhe monitorimit territorial, keto te fundit si pjesë aktuale e Drejtorisë së Hetimit Tatimor.

U krijua Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, krijimi i kësaj drejtorie si një strukturë me vete është në përputhje me ndryshimin ligjor, duke dalluar thelbësisht funksionin e hetimit tatimor nga ai i kontrollit tatimor.

Drejtoria e Kontrollit Tatimor u organizua me sektorët;

- **Kontroll tatimor i plotë në vend.** Këto kontrolle janë gjithëpërfshirëse dhe ndërmerren për të kontrolluar të gjitha aspektet e biznesit të personit të tatueshëm për të gjitha periudhat kohore që nga kontrolli i plote i fundit dhe të gjithë llojet e tatimeve. Këto kontrolle kryhen bazuar në analizën e riskut.
- **Vizitat fiskale.** Këto janë kontrolle të shkurtra të kryera gjatë një periudhe të shkurtër kohore për të verifikuar saktësinë e deklaratave dhe pagesave, si rregull vetëm për një periudhe të caktuar tatimore dhe vetëm për një lloj tatimi. Në rastet kur nga këto vizita fiskale konstatohen probleme serioze dhe dyshime të bazuara për fshehje tatimi, inspektori i kontrollit propozon kryerjen e një kontrolli të plote në vend.
- **Verifikimet në vend.** Këto verifikime të shkurtra synojnë zbulimin në kohe të shkeljeve që kanë lidhje me regjistrimin e personave të tatueshëm (identifikimin e personave të paregjistruar), me përdorimin e pajisjeve fiskale, me përdorimin e pullave fiskale në mallrat e akcizës, me dokumentimin e mallrave në ruajtje, përdorim dhe transport, me dokumentimin e shitjeve dhe lëshimin faturave tatimore, etj.
- **Drejtoria Qendra e Thirrjeve (Call-Center) nga drejtori është centralizuar në Sektor,** Sektori i Thirrjeve – Call Center, pranë Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve .

Përdorimi i Qendrave të Thirrjeve dhe dhënia e shërbimeve online ulnin ndjeshëm nevojën për kontakt nga afër me tatimpaguesit në punën për mbledhjen e borxhit. Përqendrimi i këtij funksioni kryesor në një numër më të vogël zyrash do të ndihmojë në një përdorim më efikas të burimeve të afta dhe kapacitetet më të madh për kanalizimin e burimeve në rastet me prioritet më të lartë. Kjo do të nxisë edhe një efikasitet më të madh për shkak të pasjes së ekipeve më të mëdha (dhe për rrjedhojë një raport më efikas drejtues/punonjës).

- **Qendra e Pagesave,** nisur nga objektivi i saj, veprime statistikore, analitike dhe kontabilitet, është bërë sektor nën varësi të Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit, të cilat përputhen nga vetë natyra e funksionimit.

- Është krijuar **Sektori i Komunikimit**, i cili do shërbejë për të gjitha komunikimet me tatimpaguesit dhe grupet e interesit.
- **Drejtoria e Hetimit Tatimor** e cila ka qenë e shpërndarë në 4-rajone, është centralizuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
Sektorët e zbatimit dhe monitorimit në Terren të cilat funksiononin pranë Drejtorive të Hetimit Tatimor në Rajone, janë strukturuar në:
 - **Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren në 3 Rajone.**
 - Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Qendror
 - Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Jugor
 - Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren Rajoni Verior

Kjo drejtori ushtron funksione si task forcë për kontrollin dhe monitorimin e DRT si dhe cilësinë e punës së tyre për të mbajtur standarde e cilësinë e terrenit

Suprimimi i Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë/ Sektorëve të Mbledhjes me Forcë , në Drejtori Rajonale dhe centralizimi i tyre në 3 rajone.

Me miratimin e strukturës organizative miratuar Urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës organizative dhe numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore”, është bërë centralizimi i Drejtorisë së Mbledhjes së Borxhit në 3 rajone si më poshtë:

- Drejtoria e mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Rajoni Qendror- DRT Tiranë.
- Drejtoria e mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Rajoni Jugor –DRT Fier.
- Drejtoria e mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara , Rajoni Verior-DRT Shkodër.

Qëllimi i këtij ndryshimi ishte zvogëlimi i numrit të Drejtorive / Sektorëve të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në jo më shumë se tre "Rajone të Mbledhjes Detyrimeve Tatimore të Papaguara ", si dhe në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj.

Menaxhimi i Detyrimeve Tatimore të Papaguara do të përqëndrohet në pajtueshmërinë e tanishme për të minimizuar shkallëzimin e borxhit aktual nëpërmjet përdorimit të procedurave, duke identifikuar edhe debitorët me borxhet më të vjetra për të përcaktuar veprimet më të përshtatshme procedurale.

Qëllimi kryesor i qasjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara është ndryshimi i sjelljes së tatimpaguesve dhe përdorimi i masave procedurale për të siguruar që subjektet e borxhit tatimor të mos kenë një avantazh konkurrues ndaj tatimpaguesve që përmbushin detyrimet ligjore.

Në zbatim të ndryshimeve strukturore, të Vendimeve nr. 11348 Prot., datë 06.06.2019 të Komisionit të Ristrukturimit të ngritur në zbatim të Udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016 të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”, me Urdhrin nr. 32, datë 10.05.2019 të DAP “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Administratës Tatimore Qendrore”, janë përpiluar dhe zbardhur në total 397 akte administrative.

Në zbatim të strukturës së miratuar, u bë rishikimi dhe miratimi i i përshkrimeve të punës Mbështetur në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014 “Për Përshkrimin dhe Klasifikimin e Pozicioneve të Punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Institucionet e Pavarura (e ndryshuar), Udhëzimin nr. 1, datë 31.05.2017 “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në Shërbimin Civil”.

Në zbatim dhe në funksion të strukturës janë miratuar rregulloret përkatësisht me urdhrat;

- Urdhri nr. 10, datë 31.01.2020 “Për miratimin e rregullores” Për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil, në Administratën Tatimore Qendrore”;
- Urdhri nr. 192, datë 12.08.2020 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për miratimin e “Rregullores së Brendshme të Administratës Rajonale Tatimore”;
- Urdhri nr. 193, datë 12.08.2020 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për miratimin e “Rregullores së Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore”.

Gjithashtu pas implementimit të strukturës organizative si dhe shpërndarjes së burimeve njerëzore u verifikuan dhe u pasqyruan në databazë për të cilat u krye planifikimi në sistemin e DAP dhe u vijua me hedhjen në sistemin on-line administrata.al.

Në kuadër të kryerjes së veprimtarisë funksionale, Komisioni i Posaçëm, si dhe në zbatim të rekomandimeve të KLSH, mbi kontrollin e ushtruar pranë DPT-së në vitin 2018 dhe vitin 2019, vendosi të marrë në shqyrtim praktikën e plota të gjyqfituesve – ish nëpunës civilë, të renditur sipas kronologjisë së datave përcjellëse nga Drejtoria Teknike dhe Ligjore, për ekzekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore në cilësinë e sekretariatit teknik ka vënë në dispozicion të komisionit të gjitha materialet e duhura.

Në mbledhjen e datës 10.12.2020 Komisioni i Posaçëm, sipas edhe informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, nëpërmjet tabelës së të dhënave bazë të praktikave gjyqësore, vlerësoi dhe mori në shqyrtim të githë data bazën, gjithsej 129 praktika gjyqësore.

Gjatë shqyrtimit, Komisioni i Posaçëm, mori në shqyrtim praktikat, së bashku me dokumentacionin e plotë ligjor, të gjyqfituesve të sipërcituar, ku analizoi vakancën e pozicioneve, rëndësinë dhe kriteret e pozicioneve, ndryshimet strukturore, si dhe pozicionimin aktual të gjyq-fituesve, për raste konkrete, në përputhje me përvojën/eksperiencën, arsimimin dhe për më tepër disponimin e Gjykatës, në zbatim të dispozitivit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të detyrueshëm për t'u ekzekutuar.

Komisioni mori në shqyrtim gjyqfituesit sipas Drejtorive Rajonale të ndara sipas qarqeve dhe në përfundim të analizës së fakteve dhe rrethanave, Komisioni i Posaçëm, vendosi për sistemimin e gjyqfituesve dhe vendosi pozicionimin e tyre, bazuar në vendet vakante të vëna në dispozicion nga strukturat kompetente;

Për disa gjyqfitues Komisioni konstatoi se nuk ka mundësi objektive për sistemim në Administratën Tatimore. Në respektim të dispozitave ligjore dhe në moscënim të të drejtave të gjyqfituesit, propozoi për pamundësi objektive, sistemimin nga DAP, në pozicione pune, në institucione të shërbimit civil, në zbatim dhe të dispozitivit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Përpjesën tjetër të gjyqfituesve, në analizë të vakancës së pozicioneve, rëndësisë dhe kriterëve të pozicioneve, ndryshimet strukturore, si dhe pozicionimin aktual të gjyq-fituesve, për raste konkrete, në përputhje me përvojën/eksperiencën, arsimimin dhe për më tepër disponimin e Gjykatës, në zbatim të dispozitivit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të detyrueshëm për t'u ekzekutuar, komisioni vijoi me praktiken për marrjen e pëlqimit për pozicionet e ofruara. Aktualisht jemi në procedurë, duke nxjerrë akt rekomandimet për gjyqfitues të cilët kanë pranuar pozicionin e ofruar dhe përgjigje për pretendimet e gjyqfituesve të cilët nuk kanë pranuar pozicionin e ofruar.

REKOMANDIME TË FMN-së

- 1. Maksimizimi i potencialit për rritje të të ardhurave të fiskalizimit, duke siguruar ngritjen e strukturave dhe sistemeve të duhura për monitorimin dhe zbatimin me force. Realizimi i objektivave strategjikë, nënobjektivave, aktiviteteve opracionale dhe nënaktiviteteve shoqërohet gjithmonë me risqe potencialë, që vënë në dyshim përmbushjen me sukses të tyre.**
- **Aktivitetet e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për rekomandimin:**
- a. Propozimet për ndryshime strukturore, mbështetur në implementimin e projektit të Fiskalizimit.
(Aktivitet i realizuar në vitin 2020)

2. Përmirësimi i analitikës dhe shkëmbimit të të dhënave për të shënjuar më mirë punonjësit e përegjistruar dhe nëndeklarimin.

- Aktivitetet e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për rekomandimin:

a. Përcaktimi i mënyrës së funksionimit të Drejtorisë së re që do të ngrihet. (*Aktivitet i realizuar në vitin 2020 me ndryshimet strukturore*)

3. Ngritja e një njësie të specializuar kundër evazionit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

- Aktivitetet e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për rekomandimin:

a. Mbledhje e propozimeve, argumentave nga struktura kompetente mbi përbërjen, funksionimin dhe qëllimin e njësisë së specializuar, duke bërë analizën e situatës aktuale dhe strukturave që ushtrojnë këto funksione për luftën kundër evazionit në Administratën Tatimore. (*Aktivitet i realizuar në vitin 2020*)

b. Përcaktimi i detyrave dhe qëllimit të njësisë dhe Përgatitja e formularëve të përshkrimit të punës për çdo pozicion pune brenda strukturës, (*Aktivitet i realizuar në 2020*)

c. Hartimi i Draft-Strukturës, Draft - Organigramës finale dhe relacionit miratim nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe Urdhër të Kryeministrit të Strukturës Organizative, (*Aktivitet i realizuar në 2020*)

d. Zbatim i ndryshimeve strukturore (*Aktivitet i realizuar në 2020*)

4. Ngritja e një kuadri më të strukturuar për sigurimin e pacënueshmërisës vlerave (integriteti)

- Aktivitetet e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për rekomandimin:

a. Rishikimi dhe përditesimi i kodit aktual të etikës që ka Administrata Tatimore (*Aktiviteti i realizuar për pjesën takuese nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore deri në fund 2020 pritët nga Drejtoria Teknike dhe Ligjore për miratim*)

5. Konsolidimi i punës operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në jo më shumë se tri Drejtori të mëdha Rajonale, plus Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, dhe Qendrën Kombëtare të Thirrjeve.

- Aktivitetet e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për rekomandimin:

- a. Propozime për ndryshime në Strukturën Organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në kuadër të Projektit të Fiskalizimit dhe rekomandimeve të FMN. (*Aktivitet i realizuar në 2020*)
 - b. Analiza mbi funksionimin e Strukturës sipas Modelit të Centralizimit (*Aktivitet i realizuar në 2020 me krijimin e tre DMF në rajone*)
- 6. Konvertimi i Drejtorive Rajonale Tatimore të mbetura në pika shërbimi – dhe racionalizimi më tej i rrjetit të Drejtorive Rajonale Tatimore me kalimin e kohës:**
- **Aktivitetet e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për rekomandimin:**
 - a. Analiza mbi funksionimin e strukturës sipas Modelit të Centralizimit (Referuar pikës VI.3) (*Aktiviteti duhet të rishikohet për 2021 pasi është afat mesëm*)
- 7. Marrja me kontratë e ekspertëve të analitikës së të dhënave për të kryer projekte të veçanta të analizës së të dhënave dhe përfshirja e detyrimit për transferimin e aftësive të personeli i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.**
- **Aktivitetet e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për rekomandimin:**
 - a. Ngritja e ekipeve për trajnime apo për asistencë të vazhdueshme (*Aktivitetet i realizuar për 2020 në bashkëpunim me QTATD/ASPA*)
- 8. Ndërmjetësimi pranë organeve përfaqësuese të sektorëve kryesorë të ekonomisë për t'i ofruar trajnim punonjësve të DTM-së për mënyrën se si janë të strukturuar dhe ushtrojnë aktivitet këta sektorë (p.sh., strukturat e biznesit, faktorët kryesorë të punës, zinxhirët e furnizimit, proceset dhe procedurat e shfrytëzimit, terminologjia e përdorur etj).**
- **Aktivitetet e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për rekomandimin:**
 - a. Evidentimi i nevojave për Drejtoritë Rajonale Tatimore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nëpërmjet hartimit të një pyetëso, ku të përcaktohen fushat e trajnimit, sektorët, etj (Aktivitet realizuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore për 2020).
- 9. Përzgjedhja e personelit të Qendrës Kombëtare të Thirrjeve për ngritje të aftësive për interpretimin e legjislacionit dhe teknikat e negocimit.**
- **Aktivitetet e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për rekomandimin:**
 - a. Referuar pikës VIII.1.1 dhe VIII.1.2.) (*Aktivitet i realizuar në 2020 me implementim strukture*)

10. Rekrutimi/përzgjedhja e një numri të vogël punonjësish teknik për t'u trajnuar në mënyrë intensive për interpretimin e ligjit dhe metodat e tërthorta të kontrollit. Ky grup të marrë shpërblim vjetor dhe të bëjë deklaram vjetor të të ardhurave dhe pasurive, të ngjashme me atë që kërkohet nga drejtuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Ky grup të fokusohet në projektet me prioritetin më të lartë (p.sh., llogaritë bankare offshore dhe ndërtimi).

- Aktivitetet e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për rekomandimin:

a. Referuar pikës IV.3.1; IV.3.2; IV.3.3 (*Aktivitet i realizuar në 2020*)

11. Në partneritet me Akademinë Tatimore, t'u kërkohet ndihmë Universiteteve, administratave të tjera tatimore dhe shoqatave profesionale për hartimin e programeve që synojnë zgjidhjen e boshllëqeve në aftësi.

- Aktivitetet e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për rekomandimin:

a. Identifikimi i nevojave nga Drejtoritë përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore për rritje të kapaciteteve të burimeve njerëzore (*Aktivitet realizuar në 2020*)

b. Hartimi i një Plani veprimi dhe një kalendar për nevojat dhe fushat për trajnime (*Aktivitet i realizuar në 2020 sipas programit trajnimeve QTATD/ASPA*)

c. Hartimi dhe lidhja e marrëveshjeve të ndryshme me administrata të tjera tatimore apo Universitetet me qëllim rritjen e aftësive dhe kapaciteteve, (*Aktivitet i realizuar me nënshkrimin e marrëveshjes me Universitetet në nëntor 2020 dhe procesi i implementimi do realizohet në vitin 2021*).

TRAJNIMI DHE NGRITJA E KAPACITEVE TË BURIMEVE NJERËZORE

Gjatë vitit 2020 janë trajnuar gjithsej **1040 punonjës**, në zbatim të plotë të programit vjetor të trajnimeve për vitin 2019 të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, me vendimin Nr.1, datë 20.01.2019 "Për Miratimin e Programit Vjetor të Trajnimit të Administratës tatimore Qendrore për Vitin 2020", si dhe programin e trajnimeve të miratuar me vendimin nr. 1 datë 21.01.2020 nga Bordi i MFE (Akademië Fiskale), bazuar në kalendarin e trajnimeve sipas temave të miratuar, në bashkëpunim me QTATD/ASPA.

1. Zbatimi i plotë i programit përfshin:

a. Trajnimi i nëpunësve/punonjësve të rinj dhe punonjësve ekselent të rekrutuar në administratën tatimore gjatë vitit 2020. Temat e trajnimit të zhvilluara sipas kalendarit që lidhen me përfitimin

e njohurive baze per ceshtjet tatimore (Sherbimin tatimpagues, mbledhjen me force, kontrollin tatimor etj), organizimin e administrates tatimore, marrëdhëniet e punes ne administraten tatimore , kodin e etikes, konfliktin e interesit si dhe per mashtrimet ne fushen e tatimeve (evazioni fiskal), për njohurit bazë për legjislacionin e taksave nacionale dhe lokale etj.

- b. Trajnimi nëpunësve ekzistues për temat e trajnimit te zhvilluara sipas kalendarit te miratuar nga QTATD (bordi MFE) që lidhen me çështjet tatimore.
- c. Trajnimi i nivelit drejtues (Drejtor Drejtorie/Përgjegjes Sektori) për menaxhimin e punës i zhvilluar prane QTATD me temat e trajnimit sipas kalendarit te trajnimeve por edhe trajnime te ndjekura online nga stafi sipas programit te trajnimit te ASPA.
- d. Trajnimi i punonjësve të strukturave te hetimit tatimor për legjislacionin tatimor dhe verifikimit në Terren

Trajnime të tjera jashtë programit të planifikuar dhe zhvilluara janë :

- 2. Zhvillimi i trajnimeve te tjera bazuar ne nevojat e strukturave te hetimit tatimor ne bashkepunim me institucionet e pavarura (Prokurorinë) me temë: “Evazioni fiskal në fushen e tatimeve”.
- 3. Trajnime me strukturën e auditimit per temen per çështjen e IT.
- 4. Trajnime prane ASPA për tema specifike te kërkuar nga DPT: “Certifikatë sigurisë”.
- 5. Në bashkëpunim me QTATD/ASPA, për vitin 2020 përfundoi trajnimi dhe testimi për 17-nëpunës në periudhë prove, të cilët kaluan testimin dhe kanë përfutuar certifikatën pranë ASPA. U trajnuan dhe testua 22 punonjës ekselent dhe 20 punonjes strukturave hetimit dhe verifikimit ne terren per periudhen e proves 3 mujore të cilët kaluan testimin dhe kanë përfutuar certifikatën pranë QTATD.
- 6. Jane trajnuar per procesin e fiskalizimit gjate vitit 2020 trajner lokal dhe strukura Help Desk (94 punonjes), nderkohe ky informacion i detajuar ndiqet nga DSHT.
 - Modulin e librave te shitjes/blerjes.
 - Modulin e auditit.

Për vitin 2021 janë evidentuar nevojat dhe Drejtori i Përgjithshëm me vendimin Nr. 1 , datë 07.01.2021 ka miratuar programin e trajnimeve duke përcaktuar drejtimet e synuara, organizimin dhe intsitucionet e bashkëpunimit për zhvillimin e tij. Ky program është përcjell me shkresën nr. 212, datë 07.01.2020 pranë QTATD me qëllim paraqitjen për miratimin e tij nga Bordi i Akademisë Fiskale, pranë MFE.

MASAT DISIPLINORE

a. Procedura disiplinore të filluara dhe përfunduara në 2020.

Në lidhje me procedurat disiplinore të trajtuara për vitin 2020, janë filluar ecuritë disiplinore për 175-nëpunës/punonjës të Administratës Tatimore Qendrore.

Janë shqyrtuar dhe zbardhur vendimet përfundimtare nga Komisioni i Disiplinës për 55 - ecuri disiplinore për nëpunës civil që trajtohen sipas dispozitave të ligjit mbi shërbimin civil, vendime të cilat janë përcjellë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore organeve kompetente brenda afateve të parashikuara në ligj.

Tre masa disiplinore janë trajtuar nga eprori direkt.

Për punonjës që trajtohen me dispozitat e Kodit të Punës janë zbardhur gjithsej 100 vendime sipas procedurave të përcaktuara në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve Nr. 10, datë 31.01.2020 “Për miratim e Rregullores për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil, në Administratën Tatimore Qendrore”.

Në mënyrë të detajuar trajtohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela e masave disiplinore të punonjësve Administratën Tatimore Qendrore për vitin 2020

Vendime te vitit 2020		Per ecuri 2020
A. Masa te dhena per punonjes te sherbimit civil:		55
1	Largim nga Sherbimi Civil	0
2	Mbajtje page	0
3	Pezullim ngritje ne detyre	6
4	Nxjerrje jashte juridiksioni	2
5	Verejtje	3
6	Ndërprerje e Ecurisë disiplinore	44
B. Masa te dhena per punonjesit me Kod Pune:		100
1	Zgjidhje e menjehereshme e kontrates se	1
2	Verejtje me shkrim	15
3	Verejtje me paralajmerim	4
4	Ndërprerje e Ecurisë disiplinore	80
GJITHSEJ		155
Në proces		20
TOTAL FILLIM ECURIE DISIPLINORE		175

TË DHËNAT PËR VLERËSIMET E REZULTATEVE NË PUNË PËR VITIN 2020

Për gjashtë mujorin e parë të vitit 2020 procesi i vlerësimit të rezultateve të punës, është përmbyllur për të gjithë nëpunësit/punonjësit e administratës tatimore konform procedurave të përcaktuara në ligjin Nr.152, datë 30.05.2013 ‘Për nëpunësit civil’, dhe VKM 109, datë 03.05.2014 (i ndryshuar), VKM Nr. 252/2016, si dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve Nr. 10, datë 31.01.2020 “Për miratim e

Rregullores për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil, në Administratën Tatimore Qendrore”. për strukturat të cilat trajtohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

- a. Sipas informacionit që disponojmë kemi një rezultat vlerësimi të ankimuar pranë gjykatës kompetente.

1. Vlerësimet e nëpunësve civil në Administratën Tatimore 6 –mujsori I 2020

Nr	Pozicioni punes	Gjithsej	Niveli i vlerësimit			
			Shume mire (1)	Mire (2)	Kenaqshem (3)	Jo kenaqshem (4)
1	Specialist	209	66	139	3	1
2	Inspektor	520	124	387	9	0
3	Përgjegjës Sektori	90	50	38	1	1
4	Drejtor Drejtorie	34	18	16	0	0
5	Drejtor Rajonal	14	1	11	2	0
6	Zv.Dejtor i Përgjithshëm	2	2	0	0	0
6	GJITHSEJ	869	261	591	15	2

Procesi i vlerësimit të punës për 6-mujorin e dytë të vitit 2020, është në proces përfundim dhe do vijohet me fazën e hedhjes në sistemin HRMIS dhe administrimit në dosjet e personelit.

2. Vlerësimet e nëpunësve civil në Administratën Tatimore 6 –mujsori II 2020 (e papërfunduar plotësisht)

Nr	Pozicioni punes	Gjithsej	Niveli i vlerësimit			
			Shume mire (1)	Mire (2)	Kenaqshem (3)	Jo kenaqshem (4)
1	Specialist	162	34	126	1	1
2	Inspektor	397	42	342	13	0
3	Përgjegjës Sektori	58	16	40	2	0
4	Drejtor Drejtorie	14	5	9	0	0
5	Drejtor Rajonal					
6	Zv.Dejtor i Përgjithshëm					
6	GJITHSEJ	631	97	517	16	1

Mungon:

Vlerësimet për DPT, DTM, Drejtor Drejtorie ne DRT Tirane, Drejtoret Rajonal, ZV. Drejtoret e Pergjithshem

3. Bazuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve Nr. 10, datë 31.01.2020 “Për miratim e Rregullores për marrëdhëniet e punës të personelit jo nëpunës civil, në Administratën Tatimore Qendrore”. për strukturat të cilat trajtohen sipas dispozitave të Kodit të Punës,

konkretisht vlerësimet të strukturës së Hetimit Tatimor (janë në proces) dhe Verifikimit ne Terren Administratën Tatimore dhe punonjësit e tjerë shërbimeve mbështetëse janë vjetore.

Vlerësime vjetore të strukturës së Verifikimit ne Terren në Administratën Tatimore 2020

Pozicioni punes		Gjithsej	Niveli i vlerësimit			
			Shume mire (1)	Mire (2)	Kenaqshem (3)	Jo kenaqshem (4)
1	Inspektor	115	44	71	0	0
2	Përgjegjës Sektori	5	5	0	0	0
3	Drejtor Drejtorie					
4	GJITHSEJ	120	49	71	0	0

4. Vlerësimi vjetor i rezultateve në punë për punonjësit me Kod Pune në Administratën Tatimore per vitin 2020.

Nr	Gjithsej	Niveli i vlerësimit			
		Shume mire (1)	Mire (2)	Kenaqshem (3)	Jo kenaqshem (4)
1	87	25	59	3	0

Mungojnë formularët për DPT

XII. BUXHETI DHE FINANCA

Tabela 1. Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve Viti 2020

Emri i Grupit		Ministria e Financave				Kodi i Grupit	10	
Programet		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit						
		(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2019	(2) PBA Viti 2020	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020	(5) Buxheti Vjetor Plani 2020	(6) Fakti 12 Mujori 2020	(7)=(6)-(5) Diferenca
Titulli	Emertimi							
1140	Menaxhimi i te Ardhurave Tatimore	2,870,220	3,213,000	2,947,000	2,848,400	2,848,400	2,593,122	- 255,278.0
0002	Programi 2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
0003	Programi 3	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
0004	Programi 4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
0005	Programi 5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
.....							
Totali i Shpenzimeve te Ministrise		2,870,220.0	3,213,000.0	2,947,000.0	2,848,400.0	2,848,400.0	2,593,122.0	- 255,278.0
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit								
Totali		2,870,220.0	3,213,000.0	2,947,000.0	2,848,400.0	2,848,400.0	2,593,122.0	- 255,278.0

Tabela 2. Raporti i Shpezimeve sipas artikujve buxhetore Viti 2020

Emri i Grupit							Kodi i Grupit	10
Programi	Ministria e Financave						Kodi i Programit	1140
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2019	(2) PBA Plan Viti 2020	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/p rogresiv	(6) Fakti i Periudhes/p rogresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	1,298,563	1,500,000	1,500,000	1,259,812	1,259,812	1,228,606	- 31,206
601	Sigurime Shoqërore	215,722	300,000	300,000	255,000	255,000	202,471	- 52,529
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	574,146	778,740	728,740	880,752	880,752	727,263	- 153,489
603	Subvencione							-
604	Transferata Korente të Brendshme							-

605	Transferta Korente të Huaja	1,120	1,260	1,260	3,510	3,510	3,132	- 378
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	31,764	-	-	32,326	32,326	16,134	- 16,192
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	2,121,315	2,580,000	2,530,000	2,431,400	2,431,400	2,177,606	- 253,794
230	Kapitale të Patrupëzuara	5,553	7,000	7,000	7,000	7,000	6,250	- 750
231	Kapitale të Trupëzuara	743,352	626,000	410,000	410,000	410,000	409,266	- 734
232	Transferta Kapitale							-
Nen - Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	748,905	633,000	417,000	417,000	417,000	415,516	- 1,484
230	Kapitale të Patrupëzuara							-
231	Kapitale të Trupëzuara							-
232	Transferta Kapitale							-
Nen - Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	-	-	-	-	-	-	-
Totali	Shpenzime Kapitale	748,905	633,000	417,000	417,000	417,000	415,516	- 1,484
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti		-					-	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		2,870,220	3,213,000	2,947,000	2,848,400	2,848,400	2,593,122	- 255,278

Tabela 3. Projektet e investimeve

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2020	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI I për periudhën e raportimit (12 mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
18A V806	Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash(data center), sistem telefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRT	170,000	2019	2021	74,400	36,300	35,566	35,566	109,966	
M10 0255	Pagesa e kontributit vjetor FISCALIS 2020	31,600	2015	2020	31,600	7,000	6,250	6,250	29,367	
M10 0500	Përmirësimi i modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit	1,727,792	2018	2020	1,727,792	350,000	350,000	350,000	1,188,999	
18A V811	Ngritja e sistemit për shkëmbimin e informacionit financiar me entitetet e huaja	80,040	2020	2020	80,040	23,700	23,700	23,700	23,700	

XIII. DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PROKURIMEVE

Në zbatim të ligjit të buxhetit Nr. 88/2019 Prot., “Për buxhetin e vitin 2020” dhe të Udhëzimit Nr.2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, të Udhëzimit Plotësues Nr.1, datë 17.01.2019, “Për zbatimin e buxhetin e vitin 2019”, mbështetur dhe në Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimet Publike”(i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Kreu I ,Neni 4, pika 1, bashkëlidhur, Ju bëjmë me dije ecurine e realizimit të procedurave nga prokurimit në Sektorin e Prokurimeve deri në datë 20.11.2020.

Bazuar në parashikimet e regjistrit të prokurimeve te vitit 2020, deri në 31.12.2020, janë realizuar dhe mosrealizuar procedurat e mëposhtme:

<i>Nr</i>	<i>Objekti prokurimit</i>	<i>Fondi limit pa tvsh</i>	<i>Lloji i procedurës</i>	<i>Ofertat fituese me tvsh</i>	Statusi procedurën e prokurimit	<i>Organi qe zhvillon procedurën e prokurimit</i>
1	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes 2020	38 680 562	Vendimi1 77;04.04.2 019	ILLYRIAN GUARD SHA L91619024 U	Kontrata për Qarkun Tiranë është e lidhur me Nr.23497, date 31.12.2019. Për 12 Qarqet kemi lidhur Kontratat me shoqerin Illyrian Guard per: DRT Elbasan Nr 19934/3 , dt.14.10.2020 . DRT Kukes Nr.19934/1 DRT Lezhe Nr 19934/7 / DRT Fier Nr.19934/8 DRT Vlore Nr.19934/6 / DRT Sarande Nr.19934/2 DRT Korce Nr.19934/5 / Drt Durres Nr.19934/4 DRT Gjiroka Nr.19934/13 / DRT Berat Nr.19934/11 DRT Diber Ne.19934/9 / DRT ShkoderNr 19934/10	DPT
2	Shpenzime per mirëmbajtje të mjeteve të transportit	3 333 333	Marrëveshje Kuader dy vjecare,		Lidhur Minikont I Nr.23277/1; Minikont II nr.23621/4; Minikont III nr.23221/10	ABP
3	Shpenzime blerje , gome	1,080,000	Marveshje s Kuader		E pa realizuar nga ABP ne vitin 2020 per arsye ankimimi ne KPP te operatoreve ekonomik..	ABP
4	Shpenzime blerje (Tонера)	17 666 667	Marveshje s Kuader dy vjecare	Infosoft Office	Kontrate e lidhur në vitin 2019 Marreveshje Kuader nga ABP. Minikontrata e pare është e lidhur ne 11.09.2019.Minikontratat e dyte është lidhur me nr.3529, date 20.08.2020 - Kontrate e realizuar Kemi nisur ne Ministri te Brendeshme , ABP procedure per vitin 2021-2022 me shkrese nr.20684 , date 23.10.2020	DPT

5	Shpenzime blerje (leter)	6 250 000	Marveshje s Kuader dy vjecare	Infosoft office	Kontrate e lidhur në vitin 2019. Minikontrata e pare eshte e lidhur ne 14.08.2019. Minikontratat e dyte eshte lidhur me nr.12790/7, date 27.07.2020 - Kontrate e realizuar Kemi nisur ne Ministri te Brendeshme , ABP procedure per vitin 2021-2022 me shkrese nr.20684/1 , date 23.10.2020	DPT
6	Shpenzime blerje kancelari : me baze leter dhe kancelari te tjera	2 000 000	Marveshje s Kuader dy vjecare	InfoSoft Office	Kontrate e lidhur në vitin 2019. Minikontrata e pare eshte e lidhur ne 11.09. 2019. Minikontratat e dyte eshte lidhur me nr.13546/7, date 13.08.2020 dhe 13547/7, date 13.08.2020- Kontrata te realizuara Kemi nisur ne Ministri te Brendeshme , ABP procedure per vitin 2021-2022 me shkrese nr.20684/2 , date 23.10.2020	DPT
7	Blerje Karburant	14 052 500	Kontrat		Zhvilluar perocedura e pare dhe lidhur minikontrata I me Nr.18723/2, date 13.10.2020	ABP
8	Shpenzime per prodhimin e e pullave te takses dhe tarifes	1,750,000	Me VKM 1497, datë 19.11.2008	Shtypshkronjën e Letrave me Vlere	Me Shtypshkronjën e Letrave me Vlere është lidhur kontrata nr.3115/2, date 20.02.2020, Dok Tat. Nr.285/1 09.01.2020, prodh pulla konsullore Nr.284/1, date 09.01.2020, Prodhim I biletave te transportit rrugor	DPT
9	Sigurimi i Godinave të Administratës Tatimore	8 000 000	Kontrate	Gjate vitit	Procedure e pa realizuar	DPT
10	Blerje mallra dhe sherbime per perballimin e situates se shkaktuar nga COVID - 19	12 185 603	Kontrata	Farma Net Albania K92201080V Egian Med L71715003C Flor Farma J61929017w	Lidhur kontratat me Nr:8117/1;8117/2, date 15.05.2020 Dhe kontrata 10952/1 , date 30.06.2020. Kontratat te realizuara	ABP
11	Aktekspertiza UPT	1 404 667	Kontrate	UPT+ASHK	Kontratat te realizuara	DPT

Blerjet e Vogla te realizuara 31.12.2020

1	Materiale për pastrim shërbim e ngrohje	Kontrat	Mall	375 000	XHNSH GroupL92204011T	Realizuar
1.1	Blerje material mbrojtese nga Covid-19	Kontrate	mall		Kead 11.03.2020;Bledi Loci;Ilona Gjata 25.03.2020; Ermed	Realizuar
2	Shpenzime per materiale tjera zyre dhe te pergjithshme	Kontrat	Mall	208333		
3	Shpenzime blerje dokumentacioni	Kontrat	Mall	83 333	Teuta print	Realizuar

4	Kosto e sigurimit te mjeteve te transportit	Kontrat	Sherbim	8000 000	Realizuar me Insig sha dt. 12.02.2020 Ansigg K42108801C dt.28.12.2020	Realizuar
5	Shpenzime te tjera operative	Kontrat	Mall+Sherbim	83 333	ENDRI NDINI/ L91903014L Blerje Licenca SSL	Realizuar
6	Shpenzime te taksave te paguara	Kontrat	Sherbim	450 000	DPSHTRR 05.03.2020, SGS,Bashkia Tirane	Realizuar
7	Shpenzime gjyqesore	Kontrat	Sherbim	490,000,000	Gjate vitit	Realizuar
8	Shpenzime per mirembajtje per objekte ndertimore	Kontrat	Pune	333 333	Selmani Import-Export Arkad Iljazi	Realizuar
9	Shpenzime per mirembajtje aparate ,pajisje teknike dhe vend pune	Kontrat	Pune	750 000	Adastra K32312501J	Realizuar
10	Mirembajtje kondicionimi	Kontrat	Sherbim	416 667	Altec	Realizuar
11	Shpenzime per materiale dhe sherbime speciale	Kontrat	Sherbim	12 500	Gjate Vitit	Realizuar
12	Sherbim monitorim mediatik	Kontrat	sherbim	800 000	Kontrate e lidhur me MC Monitoring Nr.969/2 dt.01.02.2020	Realizuar
13	Çertifikimi i Objektit per masa kunder zjarrit	Kontrate	Sherbim	83 333	Pellumb Tukseferi L51405023B	Realizuar
14	Pritje percjellje	Kontrate	Sherbim	83 333	Dorian VELL,10.02.2020;Cafë Club 31.01.2020;Endriti E.G 25.02.2020; Miramar 14.02.2020; Aida Berhemi 14.02.2020	Realizuar
15	Blerje paisje teknike per regjistrim	Kontrate	Sherbim	800 000	Shpresa AL L81325020I	Realizuar

Për Sektorin e Shërbimeve të Brendëshme janë ndjekur Kontratat e Dokumentacionit Tatimor të cilat janë realizuar deri me 30.08.2020 si me poshtë:

Realizimi i kontratave per vitin 2020 të biletave të transportit rrugor me "Shtypshkronjën e Letrave me Vlerë"

Kontrata nr.284/1;dt.09.01.2020

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Realizimi	Realizimi në %
1	Bileta Transporti Urban	blloqe	600 000	330 000	55
2	Bileta Transporti Ndërkombëtar	copë	500 000	150 000	30
3	Bileta të Pajtimit Mujor (Abone)	copë	1 300 000	642 300	49.4
4	Bileta Transporti Ndërqytetas	blloqe	100 000	49 100	49.5

Realizimi i kontratave per vitin 2020 të pullave me "Shtypshkronjën e Letrave me Vlerë"

Kontrata nr.285/1;dt.09.01.2020

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Realizimi	Realizimi në %
1	Pulla takse 50 leke	cope	2 000 000	1 708 200	85.4
2	Pulla takse 100 leke	copë	700 000	414 000	59
3	Pulla tarife 200 leke	copë	1 700 000	1 134 000	66.7
4	Pulla tarife konsullore 200 leke	cope	765 000	595 000	77.77
5	Pullë konsullore 10 E	copë	17 000	17 000	100
6	Pullë konsullore 20 E	copë	17 000	17 000	100
7	Pullë konsullore 30 E	copë	17 000	17 000	100

Realizimi i kontratave per vitin 2020 të dokumentacionit tatimor për vitin 2020:

Kontrata
Dt.20.02.2020;Nr 3115/2; dt.01.06.2020;
dt.20.08.2020;27.11.2020

Nr.	Artikulli	Njësia	Sasia	Realizimi	Realizimi në %
1	Faturë tatimore shitje	bllok	170 000	170 000	100
2	Faturë shoqërimi	bllok	45 000	45 000	100
3	Faturë e thjeshtë tatimore	bllok	10 000	10 000	100
4	Dëftesë tatimore (me tvsh)	bllok	8 500	8 500	100

Problematikat**Për Sektorin e Shërbimeve të Brendshme**

Problematik është dhe mungesa e magazinave për të depozituar mallrat pas përfundimit të procedurave të prokurimit. Jemi të detyruar që mallrat që kanë volum ti lëme të magazinat e distributorëve.

Mungesa e personelit në këtë Sektor pengon realizimin në kohë të detyrave.

Informacion për problematikat e Sektorit të Prokurimeve.

Procedurat të cilat zhvillohen nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara (MB) janë : “Blerje Karburant, Goma, Riparim Automjesh. Kjo Agjenci (këtu e në vijim “ABP”), në zbatim të nenit 2 të aktit normativ nr.14, datë 11.04.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, kanë vonuar procedurat e prokurimet që ne i kemi nisur që në muajin janar 2020 në MB dhe kjo na ka krijuar veshtirësi sidomos ne mirmbajtjen e automjeteve të institucionit të cilat kanë pa shërbim periodik mbi një vit.

Me miratimin e strukturës së re të administratës tatimore qendrore me Urdhrin e Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020 “Për miratimin e Strukturës Organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”. nevojitet planifikim në buxhetin shtese per 2020, bazë materiale për punonjësit shtesë sipas kësaj strukture dhe sidomos per kompjutra pasi kemi tre vjet pa prokuruar. Nevojë e domosdoshme është prokurimi i bazës materiale më të domosdoshme , karrike dhe tavolina, kompjutra.

Me lindjen e novojës për akomodim të punonjësve të rinj jemi detyruar që të lëvizim dhe ato pak hapsira që i përdornim për magazina dhe kemi marrë kioska në përdorim deri në momentin që do bëhet një rikonstruksion i ambienteve që do na liron OSHE duke hequr transformatoret.

Blerjet e Vogla kanë në cdo moment problematika pasi dalin problem të paparashikuara që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme.

Mungesa e personelit në këtë Sektor pengon realizimin në kohë të detyrave.

XIV. DIBA

Në lidhje me masat e mëtejshme me qëllim parandalimin dhe goditjen e rasteve korruptive, Drejtoria e Investigimit të Brëndshëm (Antikorrupsion) bazuar dhe në zbatimin ligjor, gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2020, *ka kryer verifikimin dhe investigimin për 32 raste të denoncuar, nga këto:*

- 32 Çështje janë regjistruar dhe investiguar;
- 2 Çështje janë referuar në Prokurori, ku janë përfshirë 5 inspektorë, referuar nenit 248 të
- 16 punonjës janë konstatuar me shkelje ligjore dhe janë referuar në Komisionin e Disiplinës:

Në lidhje me rastet e verifikuara dhe të investiguara nga ana jonë, të cilat kanë ardhur nga burime të ndryshme të informacionit, por që nuk janë regjistruar si çështje, janë gjithsej 25 raste, të cilat nuk përmbajnë dhe nuk plotësojnë kushtet e mjaftueshme për t'u regjistruar si çështje.